# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6223
E martë, 26 janar 2021
çmimi 0.40 €


## BE-ja lanson projektin 7 milionë euro për reformimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë FAQE 5




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


GRUPI NDËRKOMBËTAR I KRIZAVE KA PUBLIKUAR RAPORTIN “RINISJA E DIALOGUT KOSOVË - SERBI” FAQE 3

# ICG-ja: ASNJË NGA OPSIONET E KOMPROMISIT KOSOVË - SERBI NUK ËSHTË IDEAL

Grupi Ndërkombëtar i Krizave (International Crisis Group - ICG) ka publikuar të hënën raportin e titulluar “Rinisja e dialogut Kosovë - Serbi”. Ky raport përmban 27 faqe dhe është ndarë në pesë pjesë, në të cilat flitet për rolin e BE-së dhe ShBA-së në bisedimet dhe për tri opsionet rreth arritjes së kompromisit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ku përfshihet njohja e Kosovës nga




Serbia, autonomia për serbët e Kosovës dhe shqiptarët në Serbi si dhe për shkëmbimin e territoreve. “Asnjëri nga këto opsione nuk është as për së afërmi ideal”, ka theksuar Grupi Ndërkombëtar i Krizave. ICG-ja ka paralajmëruar se si hap i fundit, partnerët ndërkombëtarë të Kosovës duhet të përgatiten për mundësinë që dialogu të përfundojë pa asnjë zgjidhje

# PARTITË POLITIKE PARAQESIN PRIORITETET






Liderët e partive politike kanë shtuar aktivitetet politike në terren, duke takuar qytetarë dhe grupe të ndryshme të interesit. Nëpër këto takime ata po shpalosin edhe prioritetet e programeve të tyre politike. Kandidati i Lëvizjes Vetëvendosje për kryeministër, Albin Kurti, ka bërë me dije se prioritet i qeverisjes së tij do të jetë kthimi i trurit brenda vendit. Kurse kandidati i PDK-së për kryeministër, Enver Hoxhaj, ka premtuar 500 milionë euro ndihmë për bizneset



## FILLOI AKSIONI VULLNETAR I DHURIMIT TË GJAKUT NË MINISTRINË E MBROJTJES DHE FSK FAQE6

## OPINION

### KOSOVA KA NEVOJË PËR LIDERSHIP TË PJEKUR SHTETËROR, JO PËR FEUDE POLITIKE F. 8

Nga Mehmet PRISHTINA



## AKTUALE



### EDHE DHJETË TË VDEKUR NGA COVIDI DHE 311 RASTE TË REJA NË KOSOVË F. 7

### KOSOVËS I SHTOHEN EDHE 23 GJYQTARË TË RINJ F. 6

### SHËRBIMI KORREKTUES PRANON DONACION TRI AUTOMJETE TRANSPORTUESE PËR TË BURGOSURIT F. 6

## EKONOMI

### DEFICITI TREGTAR SHËNOI RRITJE PREJ 0.3-PËRQINDËSH F. 8

### ATK-ja SË SHPEJTI ME SHËRBIMIN PËR DEKLARIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE F. 8

## SPORT

### MINISTRJA DUMOSHI: NË STADIUMIN ‘RAMIZ SADIKU’ DO TË INVESTOHEN RRETH 200 MIJË EURO F. 14


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

# BE-ja propozon kufizime të reja në udhëtim



BRUKSEL, 25 JANAR - Komisioni Evropian propozoi një paketë të re masash për kufizimin e udhëtimeve, me qëllim të frenimit të përhapjes së një lloji të ri të koronavirusit. Propozimi përmban koordinim shtesë në dy fusha, ku shtetet anëtare janë pajtuar tashmë që të punojnë së bashku. Këtu bëjnë pjesë përditësimi i kodit i ngjyrave për vendet me rrezik, si dhe masa më të rrepta për udhëtarët që vijnë nga vendet me rrezik më të lartë.

Me ngjyrën e re "e kuqe e errët" do të shënohen zonat që janë më së shumti të prekura nga koronavirusi. "Kjo [ngjyrë] pasqyron një nivel të lartë infeksionesh, që pjesërisht lidhen me një variant të ri të koronavirusit", tha për gazetarët Didier Reynders, komisionar i BE-së për Drejtësinë.

Gjithashtu, me masat e reja të Komisionit Evropian "shkurajohen fuqishëm të gjitha udhëtimet e parëndësishme", ndërsa për udhëtimet e rëndësishme duhet të zbatohen masa shtesë. "Testimi do të jetë i detyrueshëm për të gjithë udhëtarët që hyjnë në BE, përfshirë edhe ata që janë në të ashtuquajturat udhëtime të rëndësishme. Testi PCR për hyrje në BE nuk duhet të jetë më i vjetër se 72 orë", tha komisionarja për Punë të Brendshme, Ylva Johanson.

Ajo tha se rregullat shtesë, përfshirë vetizolimin, karantinën dhe monitorimin e kontakteve deri në 14 ditë, duhet të zbatohen për udhëtarët që vijnë nga vendet e treta, ku qarkullimi i llojit të ri të virusit është i dukshëm. Zona e kuqe e errët, ku regjistrohen infeksione nga lloji i ri i koronavirusit, do të azhurnohet çdo javë në hartën epidemiologjike të BE-së nga Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve.

Komisioni Evropian, po ashtu, propozon që të shmanget udhëtimi në këto zona, por thotë se nëse udhëtimet janë të domosdoshme, do të kërkohet testi para nisjes në zonën e kuqe të errët dhe karantina pas kthimit - me përjashtim të njerëzve që punojnë në ato zona. Një variant i ri i koronavirusit që është shfaqur në disa vende të BE-së është detektuar për herë të parë në Mbretërinë e Bashkuar.

Ky variant është thënë se përhapet më shpejt.

# Senati do ta pranojë zyrtarisht padinë kundër Trumpit

UASHINGTON, 25 JANAR - Demokratët e Dhomës së Përfaqësuesve në Shtetet e Bashkuara do ta nisin ceremoninë e bartjes fizike të padisë ndaj ish-presidentit amerikan Donald Trump në ambientet e Senatit. Trumpi është akuzuar për "nxitje të kryengritjes" lidhur me sulmin në Kongres më 6 janar nga mbështetës të Trumpit. Demokratët do të tentojnë të bindin sa më shumë republikanë që ta dënojnë Trumpin dhe më pas të votojnë ndaras për t'ia ndaluar atij garën për president në të ardhmen.

Dhoma e Përfaqësuesve ka votuar për ta padítur Trumpin më 13 janar.

Të paktën 17 senatorë republikanë do të duhet t'iu bashkohen demokratëve në mënyrë që të dënojnë Trumpin, ndonëse një gjë e tillë ka pak mundësi të ndodhë. Trumpi është presidenti i parë amerikan që paditet për herë të dytë dhe i pari që përballet me gjyq pasi është larguar nga zyra.

Dhuna në Kongres ka shpërthyer pasi Trumpi ka pretenduar në disa raste, ndonëse pa ofruar të dhëna, se ai, në fakt, ka fituar zgjedhjet e 3 nëntorit dhe se procesi ka qenë "i manipuluar". Në orët e para të 6 janarit, mijëra mbështetës të Trumpit kanë dëgjuar thirrjen e tij për të luftuar ashpër për ta mbrojtur shtetin. Si pasojë e përleshjeve në Kongres kanë mbetur të vdekur pesë persona.



# Nëntë persona nxirren të vdekur nga një minierë në Kinë



BEIJING, 25 JANAR - Nëntë minatorë kinezë janë gjetur të vdekur një ditë pasi 11 kolegë të tyre janë shpëtuar pas dy javëve të bllokimit në një minierë ari në provincën Shandong. Kryetari i qytetit Yantai, Chen Fei, është cituar të ketë konfirmuar vdekjet, sipas transmetuesit shtetëror CCTV. Për një minator vazhdon të mos ketë informacione askush. Si pasojë e shpërthimit të 10 janarit në provincën Shandong, kanë mbetur të bllokuar 22 punëtorë, rreth 600 metra në thellësi të tokës. Një minator tjetër veçse ka vdekur.

Por, e diela ka qenë ditë gëzimi pas nxjerrjes së 11 minatorëve në sipërfaqe të tokës. "Nga pasdítja e së shtunës e deri më sot ekipet e shpëtimit nuk kanë ndalur kërkimet dhe kanë gjetur nëntë minatorë, të cilët, fatkeqësisht, kanë vdekur", ka thënë kryetari Chen Fei të hënën.

Minierat e Kinës janë ndër më vdekjeprurëset në botë.

Sipas Administratës Kombëtare për Siguri të Minave, në minierat e Kinës më 2020 janë regjistruar 573 viktima.

## Hyn në fuqi Ligji për regjistrimin e popullsisë në Maqedoninë e Veriut

SHKUP, 25 JANAR - Ligji për regjistrimin e popullsisë, i miratuar nga Kuvendi i Maqedonisë së Veriut, është dekretuar nga presidenti i shtetit, Stevo Pendarovski, ku pas këtij Enti Shtetëror i Statistikave duhet ta miratojë metodologjinë për realizimin e këtij operacioni statistikor që, siç thonë, është në përputhje me standardet dhe rekomandimet e Eurostat-it. Regjistrimi i popullsisë është paraparë të realizohet nga 1 deri më 20 prill të këtij viti, apo 19 vjet nga regjistrimi i fundit i zhvilluar në vitin 2002. "Presidenti Pendarovski pret që procesi i regjistrimit të mos politizohet dhe të dhënat e marra të jenë të dobishme për zhvillimin e përgjithshëm, që do ta mundësojnë formulimin e strategjive afatgjata në zonat vitale të vendit", ka njoftuar Zyra e presidentit pas konsultimeve që ka zhvilluar Pendarovski me ekspertë të fushave të ndryshme.



EPOKA E RE

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

PARTITË POLITIKE KANË SHTUAR AKTIVITETET PËR ZGJEDHJET E 14 SHKURTIT

# Partitë politike paraqesin prioritetet

**Liderët e partive politike kanë shtuar aktivitetet politike në terren, duke takuar qytetarë e grupe të ndryshme të interesit. Nëpër këto takime ata po shpalosin edhe prioritetet e programeve të tyre politike. Kandidati i Lëvizjes Vetëvendosje për kryeministër, Albin Kurti, ka bërë me dije se prioritet i qeverisjes së tij do të jetë kthimi i trurit brenda vendit. Kurse kandidati i PDK-së për kryeministër, Enver Hoxhaj, ka premtuar 500 milionë euro ndihmë direkte për bizneset**



EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 25 JANAR - Partitë politike kanë shtuar aktivitetet e tyre zgjedhore në terren. Të hënën liderët e partive politike kanë filluar prezantimin e prioriteteve të tyre në takimet e tyre elektorale për zgjedhjet e 14 shkurtit.
Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje dhe kandidati i kësaj partie për kryeministër, Albin Kurti, kanë vizituar Teqenë e Madhe Ballkanike të Gjakovës, ku janë pritur nga sheh Musa Shehu dhe sheh Gurfan Shehu.
Kurti ka bërë me dije se prioritet i qeverisjes së re do të jetë kthimi i trurit brenda vendit, duke ndjekur modelet e suksesshme që kanë aplikuar shtetet e tjera me një të kaluar të ngjashme si kjo e jona. “Në takimin e djeshëm, me shehët Musa e Gurfan Shehu bashkëbiseduam për domosdoshmërinë e ndryshimeve socio-politike në vend dhe për nevojën që t’i kundërvihemi migrimit të lartë e sidomos të të rinjve që janë dija dhe forca aktive për zhvillimin e vendit”, ka thënë Kurti.
Ndërsa kandidati i PDK-së për kryeministër, Enver Hoxhaj, së bashku me ish-ministrin e Drejtësisë, Abelard Tahiri, kanë prezantuar planin e rimëkëmbjes për shtetin e së drejtës dhe forcimin e sundimit të ligjit. Gjatë ditës ai ka vizituar disa biznese në Komunën e Suharekës, ku ka prezantuar planin e rimëkëmbjes ekonomike.
Gjatë vizitave në mobilierinë “Graniti”, fabrikën për përpunimin e pijeve freskuese “Burimi-AG” dhe fabrikën e materialit ndërtimor “Intertras-Coop”, Hoxhaj ka thënë se plani i “Rimëkëmbjes” do t’i adresojë të gjitha problemet me të cilat po përballen bizneset në vend, si pasojë e pandemisë Covid-19. “Sot kam vizituar tri kompani të ndryshme në Therandë, të cilat prodhojnë produkte të ndryshme për treg të brendshëm dhe për treg evropian. Pandemia i ka goditur këto kompani në Therandë, por edhe në nivel të vendit. Ne duam që të krijojmë një fond i cili përmes granteve në vlerë prej 500 milionë eurosh do t’i mbështesë shumë biznese në Kosovë, me qëllim që ta tejkalojnë pandeminë dhe të ofrojnë lehtësira të mirëfillta fiskale për gjithë sektorin privat, meqë sektorin privat e shohim si partner i rritjes ekonomike, të krijimit të vendeve të reja të punës”, ka deklaruar ai, duke treguar edhe prioritetet e tjera.
“Do ta ulim tatimin në të ardhurat për korporata nga 8 në 7, 5 dhe 0 për qind, varësisht nga përmasa e korporatës. Në krahasim me partitë e tjera politike, të cilat nuk kanë ide, nuk ofrojnë program dhe ofrojnë një qasje e cila i ngjanë më shumë komunizmit, Partia Demokratike e Kosovës ka një plan konkret sesi ta rimëkëmbë vendin në planin ekonomik. Po ashtu, pjesë e këtij plani është edhe rritja e pagës minimale nga 170 euro në 300 euro”, ka thënë Hoxhaj.



Ditë më parë kjo parti ka prezantuar edhe planin e PDK-së për rimëkëmbjen e shëndetësisë, ku përfshihen sigurimi shëndetësor dhe barna falas.
Edhe kandidati i Lidhjes Demokratike i Kosovës, Avdullah Hoti, ka prezantuar programin qeverisës, ndërsa lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, të hënën ka zhvilluar aktivitete elektoral në Prizren. Me këtë rast, ai ka thënë se AAK-ja nuk ka vija të kuqe për asnjë parti. “S’kemi ndonjë plan pas zgjedhjeve. Kemi plane për zgjedhje, pra për ta marrë besimin e qytetarëve. Koalicion bëjmë me qytetarin, ndërkaq pas zgjedhjeve s’kemi vija të kuqe për asnjë parti. Nëse na jep votën qytetari jemi në qeveri”, ka thënë Haradinaj.
I pyetur për kritikat e fundit të PDK-së për të, ai ka treguar arsyen pse nuk merret me PDK-në. “Këto ditë PDK-ja po na nguc pak. Unë nuk mund t’i nguci sepse i kam duart e lidhura, sepse Thaçi e Veseli nuk janë këtu. Mendoj se ne të gjithë duhet të kujdesimi që pas zgjedhjeve për të krijuar një unitet në Kosovë për t’i krijuar institucionet e reja”, ka thënë ai.
Kurse lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, i shoqëruar nga ministri në detyrë i



Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, kanë vizituar familjen Avdyli e cila jeton në veri të Kosovës. Limaj ka thënë se Kosova si tërësi mund të rregullohet e fuqizohet vetëm falë një angazhimi të përbashkët nacional. “Bashkë me ministrin Reçica sot ishim për vizitë në familjen e nderuar Avdyli nga Mitrovica, në pjesën veriore, me të cilin diskutuam për sfidat dhe shqetësimet me të cilat ballafaqohen shqiptarët tanë aty. Familjen Avdyli e falënderova për pritjen dhe vullnetin e treguar për ta mbështetur kauzën tonë për mbrojtjen e vlerave kombëtare. Kosova si tërësi mund të rregullohet e të fuqizohet vetëm falë një angazhimi të përbashkët nacional”, ka shkruar Limaj në llogarinë e vet në “Facebook”.



## PZAP-i SOT PRITET TË VENDOSË RRETH ANKESAVE TË PARTIVE

Kryesuesi i Sekretariatit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, Mul Desku, ka treguar se sot (e martë) është afati i fundit që të vendoset për ankesat e partive politike që janë ankuar në këtë institucion. Të premten Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk ka certifikuar listat e kandidatëve për deputetë të gjashtë subjekteve politike, në mesin e tyre edhe listën e Lëvizjes Vetëvendosje, Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nismës Socialdemokrate.
KQZ-ja ka bërë me dije se këto lista nuk janë certifikuar për shkak se këto parti nuk i kanë zëvendësuar emrat e kandidatëve që në listat sipas Këshillit Gjyqësor të Kosovës, kanë pasur dënime për vepra penale në tre vjetët e fundit. Pas moscertifikimit, këto gjashtë subjekte politike kanë dorëzuar tetë ankesa në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), por që deri tani ende nuk është marrë ndonjë vendim për to. KQZ-ja ka certifikuar listën e LDK-së dhe të PDK-së, pasi këto dy parti kishin zëvendësuar nga një kandidat që kishte qenë i dënuar. Po ashtu, KQZ-ja ka certifikuar edhe Listën Serbe.




GRUPI NDËRKOMBËTAR I KRIZAVE KA PUBLIKUAR RAPORTIN "RINISJA E DIALOGUT KOSOVË - SERBI"

# ICG-ja: Asnjë nga opsionet e kompromisit Kosovë - Serbi nuk është ideal

Grupi Ndërkombëtar i Krizave (International Crisis Group - ICG) ka publikuar të hënën raportin e titulluar "Rinisja e dialogut Kosovë - Serbi". Ky raport përmban 27 faqe dhe është ndarë në pesë pjesë, në të cilat flitet për rolin e BE-së dhe ShBA-së në bisedimet dhe për tri opsionet rreth arritjes së kompromisit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ku përfshihet njohja e Kosovës nga Serbia, autonomia për serbët e Kosovës dhe shqiptarët në Serbi si dhe për shkëmbimin e territoreve. "Asnjëri nga këto opsione nuk është as për së afërmi ideal", ka theksuar Grupi Ndërkombëtar i Krizave. ICG-ja ka paralajmëruar se si hap i fundit, partnerët ndërkombëtarë të Kosovës duhet të përgatiten për mundësinë që dialogu të përfundojë pa asnjë zgjidhje

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

**Prishtinë, 25 janar** - Janë tri mundësi rreth kompromisit të mundshëm ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, vlerëson Grupi Ndërkombëtar i Krizave (International Crisis Group - ICG). Këtu përfshihet njohja e Kosovës nga Serbia, autonomia për serbët e Kosovës dhe shqiptarët në Serbi si dhe shkëmbimi i territoreve. Ky grup thotë se deri te një marrëveshje gjithëpërfshirëse, që do t'i zgjidhte të gjitha çështjet kryesore sa i përket pavarësisë së Kosovës, rruga është e "turbullt, por edhe e ngushtë".

Në raportin e titulluar "Rinisja e dialogut Kosovë - Serbi", publikuar të hënën, Grupi Ndërkombëtar i Krizave thotë se, pavarësisht se Kosova dhe Serbia që nga viti 2006 bisedojnë me disa ndërprerje, të dy vendet janë pajtuar në shumë çështje, por edhe kanë mospajtime për çështjen kryesore: Pavarësinë e Kosovës.

Sipas raportit të grupit ndërkombëtar të krizave, deri te një marrëveshje gjithëpërfshirëse mund të arrihet nëse Prishtina dhe Beogradi zyrtar ndryshojnë qasjen. "Kushtetuta e Serbisë kërkon që çdo marrëveshje që i jep pavarësinë Kosovës duhet të miratohet përmes një referendumi, por udhëheqësia politike nuk ka bërë asgjë që t'i përgatisë votuesit për kompromiset që duhen të bëhen që të arrihet marrëveshja. Kosova nuk ka kërkesa të tilla kushtetuese, por udhëheqësit e saj mund të vendosin që ta vënë në votim marrëveshjen për hir të legjitimitetit dhe në çdo rast do të duhej të përgatisnin publikun e Kosovës për koncesionet që duhen bërë për të arritur një gjë të tillë (marrëveshjen)", thuhet në raport.

Grupi Ndërkombëtar i Krizave thotë se nëse Serbia njeh pavarësinë Kosovës, atëherë kjo me gjasë mund të përfshijë një infuzion të ndihmës ndërkombëtare, autonomi më të madhe për serbët e Kosovës apo edhe shkëmbim territoresh ose fuqizim të mbështetjes në kombinim me njërën nga këto dy opsione.

Bashkimi Evropian, por edhe Shtetet e Bashkuara, kanë qenë të përfshira në ndërmjetësimin e normalizimit të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë.

Më 2018 në publik është shfaqur ideja për ndryshimin e kufijve, si një zgjidhje për arritjen e një marrëveshjeje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Kjo ide ka nxitur reagime për dhe kundër në Prishtinë dhe Beograd, por edhe në mesin e komunitetit ndërkombëtar. Por, Grupi Ndërkombëtar i Krizave thotë se Bashkimi Evropian, ndërmjetësuesi i procesit të dialogut politik, pavarësisht prej shqetësimeve të legjitimitetit, nuk duhet ta përjashtojë asnjë zgjidhje që është në përputhje me të drejtat e njeriut dhe ligjin ndërkombëtar. "Paralelisht, ShBA-ja duhet të krijojë një pozicion të suksesshëm të negocimit në elitën e çrregulluar politike të Kosovës dhe partnerët e Kosovës duhet të ndihmojnë atë që të ketë marrëdhënie më të mira dypalëshe dhe shumëpalëshe në pritje të një marrëveshjeje", thuhet në raportin "Rinisja e →

dialogut Kosovë - Serbi”.
Sipas Grupit Ndërkombëtar të Krizave, janë tri opsione kryesore se si do të mund të dukej një marrëveshje gjithëpërfshirëse ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.
Një mundësi do të ishte që Serbisë t’i jepej një mbështetje për zhvillim nga donatorët dhe përshpejtimi i rrugës për anëtarësim për njohje si një çmim për njohjen e Kosovës. E dyta, do të ishte këmbimi i njohjes nga Serbia për krijimin e rajoneve autonome të serbëve në Kosovës dhe për shqiptarët që jetojnë në Serbi dhe opsioni i tretë, do të ishte rikthimi i qasjes për shkëmbim territoresh, që ishte elementi kyç i draftmarrëveshjes së vitit 2018. “Asnjëri nga këto opsione nuk është as për së afërmi ideal”, ka theksuar Grupi Ndërkombëtar i Krizave.
Për opsionin e parë, ky grup thotë se duke pasur parasysh dinamikat e brendshme, thjesht mund të jetë e pamundshme që BE-ja të premtojë përshpejtim të procesit të anëtarësimit. Në mes të këtyre opsioneve, në raport thuhet se opsioni i autonomisë duket si “zgjidhje më e mirë”. “Veçanërisht, liderët e Kosovës duket se e kundërshtojnë këtë, ndoshta sepse shqetësohen se kjo mund të çojë në një qeverisje sklerotike që ata e kanë parë në Bosnje e Hercegovinë, ku shumica e vendimeve kërkojnë që dy nga tre entitetet të votojnë për”, thuhet në raport.
Raporti, po ashtu, thekson se për këtë opsion disa qeveri evropiane, veçanërisht Gjermania, ka shqetësime legjitime lidhur me të, pasi ata argumentojnë se rishkrimi i kufijve në Ballkan mund të jetë precedent destablizues.
Sipas Grupit Ndërkombëtar i Krizave për këtë opsion duhet të ketë mbështetje të publikut, andaj BE-ja dhe ShBA-ja “kanë një rol në këtë përpjekje”. “BE-ja duhet të vendosë nëse do ta ndryshojë pozicionin e saj të përbashkët, në mënyrë që të përcaktojë në mënyrë të qartë arritjen e një marrëveshjeje përfundimtare bazuar në njohjen reciproke (diçka që pesë shtetet mosnjohëse të BE-së e kanë kundërshtuar deri më tani) dhe të sqarojë se si ndërmjetësuese nuk do ta përjashtojë mundësinë që të bisedohet edhe për autonominë apo mundësinë e shkëmbimit të territoreve. Ndërkaq ShBA-ja duhet të punojë me Qeverinë e Kosovës për të zhvilluar një strategji negociuese, bazuar në atë që njohja është e mundur, por kërkon koncesione”, thotë ky grup.
Grupi Ndërkombëtar i Krizave paralajmëron se si hap i fundit partnerët ndërkombëtarë të Kosovës po ashtu duhet të përgatiten për mundësinë që dialogu të përfundojë pa asnjë zgjidhje. “Nën këto rrethana, strategjia më e mirë do të ishte që të shikohen mundësitë që do t’i lejonin Kosovës ta vazhdojë integrimin në institucionet ndërkombëtare, ta zhvillojë ekonominë si dhe t’i forcojë marrëdhëniet e sigurisë dhe politike me pjesën tjetër të botës. Po ashtu, ata mund t’i ridrejtojnë investimet dhe ndihmën e tyre dedikuar Ballkanit drejt Prishtinës zyrtare. Kjo gjë, po ashtu, do të shërbente si përkujtues për Beogradin se nuk ka veto të përhershme për të ardhmen e Kosovës”, thuhet në këtë raport të Grupit Ndërkombëtar të Krizave.
Në raportin “Rinisja e dialogut Kosovë - Serbi”, po ashtu theksohet ndikimi që vazhdon të ketë Serbia në komunitetin serb në Kosovë. Aty theksohet se zonat e banuara me shumicë serbe, veçanërisht katër komunat në veri të Kosovës, të cilat mbesin pjesërisht të integruara, paraqesin “pikën e mundshme për dhunë”.
Në raport thuhet se serbët e zgjedhur në Kuvendin e Kosovës dhe ata që emërohen në poste qeveritare, hapur ndjekin urdhrat që marrin nga Beogradi zyrtar.
Dialogu politik Kosovë - Serbi me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian ka nisur më 2011. Ky dialog është thënë se ka për synim normalizimin e raporteve. Për 20 muaj, që prej fundit të vitit 2018, bisedimet u ndërprenë për shkak se Prishtina zyrtare vendosi taksë për produktet nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina.
Me heqjen e taksës dhe masave të reciprocitetit, dialogu rinisi në korrik të vitit 2020. Por, palët shprehën mospajtime për një çështje: Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Kosova thotë se ky asociacion do të krijohet në bazë të marrëveshjeve paraprake të arritura në kuadër të dialogut të Brukselit, por Serbia insiston që ai të ketë kompetenca ekzekutive.
Grupi Ndërkombëtar i Krizave është një organizatë e pavarur ndërkombëtare, me qendër në Bruksel, ka 120 anëtarë në të gjithë botën, të cilët përpiqen, nëpërmjet analizave dhe avokatisë, t’i parandalojnë konfliktet dhe t’i zgjidhin konfliktet e mbetura pezull.

# BE-ja lanson projektin 7 milionë euro për reformimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë




EPOKA E RE Qendresa RAMA

**Prishtinë, 25 janar** - Shefi i Zyrës i Bashkimit Evropian në Kosovë/përfaqësuesi special i BE-së, ambasadori Tomas Szunyog, së bashku me ministrin e Drejtësisë, Selim Selimi, kryesuesin e Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial, Skënder Çoçaj, si dhe drejtorin e Akademisë së Drejtësisë, Enver Fejzullahu, lansuan programin e Bashkimit Evropian/sektorit të drejtësisë në Kosovë. Projekti do të zbatohet deri në janar të vitit 2024 dhe ka një buxhet prej 7 milionë eurosh.
BE-ja aktualisht është duke investuar rreth 50 milionë euro të fondeve të Instrumentit të Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA) për sundimin e ligjit në Kosovë. Projekti do të punojë me Ministrinë e Drejtësisë, Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës dhe Akademinë e Drejtësisë si dhe me aktorë të tjerë kyçë në këtë sektor. Fokusi kryesor i projektit është përmirësimi i koordinimit në sektorin e drejtësisë dhe mbështetja për zbatimin e strategjisë së sektorit të sundimit të ligjit. Një draft i kësaj strategjie është vënë në konsultim më 18 janar.
BE-ja dhe partnerët e tjerë ndërkombëtarë e kanë mbështetur këtë iniciativë.
Programi synon reformimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare. Ky program do t’i ndihmojë institucionet në konsolidimin e kornizës ligjore dhe institucionale, forcimin e pavarësisë, paanshmërisë, llogaridhënies, profesionalizmit, cilësisë, efikasitetit dhe transparencës së gjyqësorit dhe, po ashtu, do ta përmirësojë qasjen në drejtësi për çdo qytetar, veçanërisht për gratë dhe grupet e pafavorizuara ose të margjinalizuara.
Shefi i Zyrës i Bashkimit Evropian në Kosovë, Tomas Szunyog, ka theksuar se një sistem i drejtësisë i pavarur, i paanshëm dhe profesional është element thelbësor për një shoqëri demokratike dhe se qytetarët e Kosovës kanë plotësisht të drejtë të presin që të kenë institucione të pavarura dhe profesionale të sundimit të ligjit në shërbim të tyre dhe që këto institucione të sigurojnë të drejtat e tyre civile dhe të luftojnë korrupsionin dhe krimin e organizuar në mënyrë efikase. Ky projekt zbatohet nga Fondacioni Gjerman për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar (IRZ) si partner udhëheqës së bashku me partnerët e projektit: Qendrën për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar (CILC, Holandë) dhe Ministrinë e Drejtësisë së Kroacisë.

## Kosovës i shtohen edhe 23 gjyqtarë të rinj

PRISHTINË, 25 JANAR (ER) - Në pajtim me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGjK), ushtruesja e detyrës së presidentit, Vjosa Osmani, ka dekretuar të hënën 23 gjyqtarë të rinj.
Kryesuesi i KGjK-së, Skënder Çoçaj, iu ka uruar mirëseardhje gjyqtarëve të rinj, duke shprehur gatishmërinë për bashkëpunim në funksion të forcimit të sistemit të drejtësisë në vend. Çoçaj ka kërkuar nga gjyqtarët e rinj përkushtim dhe përgjegjësi të lartë. Duke u bazuar në ligjet në fuqi, kandidatët për gjyqtarë, para se të dërgohen te presidentja për emërim, i janë nënshtruar procesit të zgjedhjes, proces të cilin e ka udhëhequr KGjK-ja. Gjyqtarët e rinj do të shpërndahen nëpër shtatë gjykatat themelore të Republikës së Kosovës.



# Ambasadori Minxhozi viziton Agjencinë Kadastrale

PRISHTINË, 25 JANAR (ER) - Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK), si organ kompetent për administrimin e regjistrave pronësorë, për kadastër dhe hartografi, për sistem të unifikuar të adresave dhe për infrastrukturë të informacioneve hapësinore, është pjesë e nismave të ndryshme regjionale dhe ndërkombëtare, që kanë për qëllim shpërndarjen e shërbimeve gjeohapësinore për palë të ndryshme të interesit. Pjesëmarrja në këto nisma ka ndikuar edhe në ngritjen e kualitetit të shërbimeve që u ofrohen institucioneve dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës e jashtë saj, ka ndikuar në lehtësimin e qarkullimit të njerëzve e të kapitalit, ka ndihmuar në administrimin e gjendjeve emergjente e ngjashëm.
Ndërsa me qëllim të identifikimit të fushave të interesit të përbashkët, ku bashkëpunimi do të mund të avancohej edhe në të ardhmen, si dhe për t'i identifikuar hapat që duhet të ndërmerren për ta shtuar këtë bashkëpunim, AKK-në e ka vizituar ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi, i cili në takim u prit nga kryeshefi ekzekutiv i kësaj agjencie, Avni Ahmeti dhe drejtoresha e Drejtorisë për Teknologji të Informacionit, Afërdita Thaçi. Në takimin në fjalë, pos prezantimit të aktiviteteve të institucioneve respektive, prijësit e institucioneve u pajtuan që bashkëpunimi ndërinstitucional të thellohet, e sidomos kur bëhet fjala për institucione homologe nga Republika e Kosovës dhe Republika e Shqipërisë duke marrë parasysh edhe ndërveprimet e përditshme ekonomike e kulturore mes dyja shteteve.
Si rezultat i këtij takimi së shpejti pritet që të shkëmbehen



shërbime dhe produkte gjeohapësinore të brezit kufitar në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë të cilat do ta ndihmonin zbatimin e projekteve të ndryshme infrastrukturore e mjedisore nga autoritetet e të dy shteteve.

# Shërbimi Korrektues pranon donacion tri automjete transportuese për të burgosurit



PRISHTINË, 25 JANAR (ER) - Shërbimi Korrektues i Kosovës në kuadër të bashkëpunimit me Ambasadën Amerikane në Prishtinë, në veçanti nga Programin ICITAP & INL ka pranuar donacionin e radhës nga Byroja për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit (INL).
ShKK-ja gjatë këtij muaji nga INL-ja ka pranuar donacion në vlerë prej 172 000 dollarësh, në të cilin përfshihen tri automjete transportuese, të cilat do të përdoren nga Njësia për Përcjelljen e të burgosurve, 700 batanije, 200 llamba ndriçuese "Flash Lights", si dhe set pajisjesh mbrojtëse për intervenime të shpejta kundër trazirave. Dhurimi i këtij donacioni ka për qëllim rritjen e nivelit të sigurisë në transportimin e të burgosurve, sigurisë brenda institucioneve korrektuese, si dhe përmirësimin e kushteve të punës dhe ambientit brenda ShKK-së.
ICITAP & INL me donacionet e saj po vazhdon ta mbështesë fuqishëm zhvillimin e ShKK-së, duke aspiruar për ndërtimin e një sistemi të avancuar, të pavarur, të sigurt dhe të vetëqëndrueshëm.

## Filloi aksioni vullnetar i dhurimit të gjakut në Ministri të Mbrojtjes dhe FSK

PRISHTINË, 25 JANAR (ER) - Në Ministrinë e Mbrojtjes ka filluar aksioni humanitar për dhurimin vullnetar të gjakut për vitin 2021, i cili aksion do të vazhdojë të realizohet për dy javë në të gjitha kazermat e FSK-së.
Aksioni është organizuar nga Qendra Mjekësore e FSK-së së bashku me Regjimentin Mjekësor dhe në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut të Kosovës. Dhurimi vullnetar i gjakut në këtë kohë është më se i nevojshëm, duke parë nevojat e përditshme për gjak të QKTGJK-së, por edhe mjaft sfiduese për shkak të gjendjes së vazhdueshme me pandeminë Covid-19.
Forca e Sigurisë së Kosovës është e angazhuar që përmes dhurimit vullnetar të gjakut të gjendet sa më afër qytetarëve për t'u dalë në ndihmë atyre që më së shumti u nevojitet gjaku në këtë situatë pandemie. Në ditën e parë aksionit vullnetar i janë përgjigjur një numër i madh i zyrtarëve të Ministrisë së Mbrojtjes dhe pjesëtarëve të FSK-së. Dhurimi vullnetar i gjakut, në kuadër të FSK-së, tashmë është bërë traditë me moton "Një pikë gjak për shpëtimin e një jete".



# KMDLNj: Liderët duhet t'i mbrojnë institucionet e pavarura dhe jo t'i sulmojnë

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 25 JANAR - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka reaguar ndaj zhvillimeve të fundit në vend si pasojë e zgjedhjeve të reja dhe akuzave në drejtim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).
KMDLNj ka theksuar se duke respektuar ligjin liderët duhet t'i mbrojnë institucionet e pavarura dhe jo t'i sulmojnë ato.
"Komisioni Qendror për Zgjedhje është një institucion i pavarur që ka përgjegjësi ligjore dhe kushtetuese për organizimin dhe mbarëvajtjen e zgjedhjeve dhe, deri më tani, këtë punë e ka kryer me kompetencë duke u radhitur ndër institucionet më të besueshme. Ka 11 anëtarë me të drejtë vote dhe kryetare është Valdete Daka, që është e para në mesin e të barabartëve në kohën që fuqia e votës së saj është e njëjtë me anëtarët e tjerë që nënkupton se nuk e ka forcën e votës deliberative (përcaktuese) nëse është votimi 50 për qind me 50 për qind. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese i Kosovës, sidomos ai për përjashtimin e 47 kandidatëve nga e drejta për të garuar në zgjedhjet e radhës, ka ndikuar që KQZ të jetë institucioni më i sulmuar në Kosovë, kurse kryetarja e KQZ-së, znj. Valdete Daka, të jetë personi më i linçuar dhe më i kërcënuar në Kosovë në kohën kur as KQZ-ja e as Valdete Daka nuk kanë asnjë përgjegjësi, subjektive apo objektive qoftë ajo. Edhe KQZ-ja si dhe kryetarja Valdete Daka e kanë ligjin sikur edhe një vendim të Gjykatës Kushtetuese dhe, çdo refuzim i zbatimit të ligjit bartë përgjegjësi penale sikur që çdo përpjekje, kërcënim, shantazhim apo linçin, si ndaj KQZ-së dhe kryetares Valdete Daka, është




sulm i drejtpërdrejtë mbi pavarësinë e këtij institucioni dhe përpjekje për instrumentalizim si dhe futje nën kontroll politike. Gjuha që po përdoret ndaj KQZ-së dhe Valdete Dakës është i pashembullt për një vend demokratik dhe ku sundon ligji, prandaj duhet të ndalen të gjitha sulmet në mënyrë që zgjedhjet të mbahen me kohë dhe papengueshëm", thuhet në reagimin e KMDLNj-së.
Sipas KMDLNj-së, politikanët të cilët me të drejtë apo pa të drejtë nuk janë të kënaqur me vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe të cilat, për fat të keq, janë të pakundërshtueshme, me të ardhur në pushtet apo edhe nga opozita duhet ta nisin procesin e ndryshimeve të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese duke ia hequr monopolin ekskluziv për marrje të vendimeve e që thuaja në shumicën e rasteve po prodhojnë efekte dhe pasoja politike duke shkaktuar kriza të shumta. "Mund ta marrin shembullin e Shqipërisë apo ndonjë praktikë tjetër ku Gjykata Kushtetuese mbikëqyret nga Kuvendi apo Këshilli i Ministrave. Legjislatura e re duhet të kërkojë të bëhet edhe ndryshimi i rekrutimit dhe intervistimit të kandidatëve për Gjykatë Kushtetuese të Kosovës për faktin se mënyra e deritashme është treguar joefikase. Liderët politikë duhet të jenë ata që nuk duhet të lejojnë sulmet ndaj KQZ-së dhe Valdete Dakës dhe, me shembullin e tyre duhet të dëshmojnë se janë për një shtet ligjor dhe shtet të së drejtës e që, së paku deri më tani, një numër i tyre e kanë bërë të kundërtën", theksohet në reagimin e KMDLNj-së.

# Edhe dhjetë të vdekur nga Covidi dhe 311 raste të reja në Kosovë



EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 JANAR - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë janë testuar gjithsej 1 903 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 311 raste pozitive.
Brenda 24 orëve janë raportuar dhjetë raste të të vdekurve si pasojë e këtij virusi.
Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Lipjan dy raste (29, 76 vjeç), Skenderaj dy raste (78, 61 vjeç), Dragash një rast (82 vjeç), Fushë-Kosovë një rast (85 vjeç), Malishevë një rast (78 vjeç), Pejë një rast (61 vjeç), Prizren një rast (74 vjeç), Suharekë një rast (67 vjeç).
Numri total i rasteve pozitive është 58 399 raste nga 221 663 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 466 raste të vdekjes.
Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 128 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 51 081 raste, kurse numri i rasteve aktive është 5 852.
Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 84 raste, Prizren 83 raste, Fushë-Kosovë 21 raste, Klinë 14 raste, Malishevë 13 raste, Suharekë 12 raste, Pejë 11 raste, Lipjan 10 raste, Vushtrri 10 raste, Drenas 8 raste, Istog 7 raste, Dragash 6 raste, Gjakovë 5 raste, Rahovec 5 raste, Ferizaj 4 raste, Obiliq 4 raste, Podujevë 4 raste, Mitrovicë 3 raste, Skenderaj 2 raste, Viti 2 raste dhe me nga një rast komunat Deçan, Gjilan dhe Kamenicë.

# Të merren mësime nga vërshimet e fundit në Kosovë

PRISHTINË, 25 JANAR (ER) - Tahir Ahmeti, njohës i çështjeve të emergjencave, njëherësh drejtor ekzekutiv i Qendrës Kërkimore për Politika të Sigurisë (SPRC), ka thënë se vërshimet e fundit që ndodhen në Kosovë, do të duhej të ishin një mësim i mirë për institucionet në Kosovë, si ato qendrore ashtu edhe ato lokale.
"Këto vërshime shpërfaqen mangësi të shumta, organizative, menaxhuese dhe operacionale. Ka mungesë të planifikimeve dhe mungesë të burimeve dhe kjo e zvogëlon efektivitetin e reagimit në raste të tilla. Duhet të shtohet puna e vazhdueshme preventive dhe parandaluese për rregullimin e shtretërve të lumenjve, kanaleve të hapura dhe përroskave, po ashtu edhe për përmirësimin e infrastrukturës nëntokësore në vendet urbane, në mënyrë që të pakësohet mundësia e vërshimeve sa herë që kemi reshje më të theksuara", ka thënë ai.
Gjithashtu, Ahmeti ka thënë se duhet të ketë koordinim më të mirë ndërmjet institucioneve përgjegjëse, si dhe të mbahen ushtrime dhe simulime të rregullta të këso lloj situatave, në mënyrë që në të ardhmen reagimi të jetë i plotë dhe profesional.



# Deficiti tregtar shënoi rritje prej 0.3-përqindësh



Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 25 JANAR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat lidhur me rrjedhat e eksportit dhe importit për muajin dhjetor 2020. Të dhënat nga Tregtia e Jashtme të Mallrave në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar më të lartë për 0.3 për qind në muajin dhjetor 2020, në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2019, gjegjësisht në vlerë prej 309.2 milionë eurosh, krahasuar me deficitin prej 308.3 milionë eurosh në vitin 2019.

Sipas raportit të ASK-së, eksporti mbulon importin me 13.1 për qind. "Eksporti i mallrave në muajin dhjetor 2020 kishte vlerën 46.7 milionë euro, ndërsa importi 355.9 milionë euro, që është një rritje prej 73.6-përqindësh për eksport dhe 6.2 për qind për import, duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019. Sipas të dhënave të grupeve kryesore të eksportit: 36.6 për qind të eksporteve e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 14.6 për qind e përbëjnë artikujt e ndryshëm të prodhuar; 11.2 për qind e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 9.3 për qind e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 5.1 për qind e përbëjnë produktet minerale; 4.8 për qind e përbëjnë produktet bimore; 4.7 për qind e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike etj", është thënë në raportin e ASK-së.

Duke iu referuar këtij raporti, sipas të dhënave të grupeve kryesore për import: 15.4 për qind e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 13.5 për qind e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 10.7 për qind e përbëjnë produktet minerale; 10.4 për qind e përbëjnë mjetet e transportit; 10.1 për qind e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 7.5 për qind e përbëjnë produktet e industrisë kimike; 5.6 për qind e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre, etj.

"Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 12.9 milionë euro ose rreth 27.7 për qind e eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 15.6-përqindësh. Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në BE janë: Gjermania (8.9 për qind), Italia (6.1 për qind), Holanda (2.2 për qind) etj. Importet e Kosovës nga vendet e BE-së ishin rreth 165.2 milionë euro, ose 46.4 për qind e importeve të përgjithshme, me një rritje prej 1.8-përqindësh. Importet me pjesëmarrje më të lartë ishin nga: Gjermania (14.0 për qind), Italia (5.6 për qind), Greqia (3.8 për qind), Polonia (3.3 për qind) etj", thuhet tutje në raport, duke u bërë me dije se në muajin dhjetor 2020 eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s arritën në 23milionë euro ose 49.4 për qind të eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 89.6-përqindësh.

Partnerë kryesorë për eksport nga vendet e CEFTA-s ishin: Shqipëria (30.7 për qind), Maqedonia e Veriut (9.5 për qind), Serbia (4.7 për qind) dhe Mali i Zi (3.2 për qind).

Ndërsa importet nga vendet e CEFTA-s në muajin dhjetor 2020 arritën në 69.2 milionë euro ose 19.4 për qind të importeve të përgjithshme, me një rritje prej 67.6-përqindësh.

Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin: Serbia (6.5 për qind), Shqipëria (5.7 për qind), dhe Maqedonia e Veriut (5.3 për qind).

Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 10.6 milionë euro ose 22.9 për qind. Si partnerë më të rëndësishëm nga këto vende për eksport vlen të përmenden: Zvicra (8.5 për qind) dhe ShBA (8.1 për qind), kurse importet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 121.5 milionë euro ose 34.1 për qind. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin: Turqia (11.7 për qind) dhe Kina (10 për qind).

# Si pasojë e turbullirës në kanalin e Ibër Lepencit në disa komuna ka pasur shkurtim të ujit të pijshëm



PRISHTINË, 25 JANAR (ER) - Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Prishtina" ka njoftuar të hënën se do të ketë shkurtime të ujit të pijshëm në Obiliq, Fushë-Kosovë, Drenas dhe lagjen "Kalabria" në kryeqytet. Sipas kompanisë, shkurtimet janë si pasojë e turbullirës në kanalin e Ibër Lepencit. "Si pasojë e reshjeve të shiut ditët e fundit janë rritur rrjedhjet sipërfaqësore në zonat fushore dhe pastaj të njëjtat kanë përfunduar sërish te kanali i Ibër Lepencit, prej të cilit merret uji i papërpunuar për t'u trajtuar pastaj për pije (ITUP Shkabaj). Për këtë shkak kemi rritje të turbullirës në atë nivel që bën të pamundur trajtimin e ujit për pije konform standardeve dhe teknologjisë që kemi. Me qëllim që ta ruajmë kualitetin e ujit për pije, t'i ruajmë pajisjet teknologjike, jemi të detyruar të zvogëlojmë në minimum prodhimin e ujit nga ky impiant, me ç'rast jemi detyruar ta ndërpresim furnizimin me ujë të pijshëm për konsumatorët e zonave: Obiliq, Fushë-Kosovë, Drenas dhe lagjja 'Kalabria' në Prishtinë. Si pasojë e ndërprerjes së punës në ITUP Shkabaj, edhe disa zona të tjera në Prishtinë do të kenë shkurtime në periudhën e mesditës dhe gjatë natës, më konkretisht ata të cilët furnizohen me ujë nga sistemi i Badocit si dhe nga Kodra, për shkak të alternativave teknike për furnizim të zonave më të afektuara nga kjo turbullirë. Në momentin që kushtet lejojnë që uji të trajtohet dhe të garantohet cilësia e duhur pas trajtimit, ne do ta rikthejmë gjendjen normale me trajtim dhe furnizim", ka njoftuar KRU "Prishtina".

# Fillojnë punimet për zgjerimin e rrugës në hyrje të qytetit të Ferizajt

Ferizaj, 21 janar (ER) - Kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, mori pjesë në fillimin e punimeve për zgjerimin e rrugës në hyrje të qytetit të Ferizajt, projekt të cilin e quajti të rëndësishëm jo vetëm për këtë komunë, por për tërë rrjetin infrastrukturor dhe rrugor në nivel vendi. "Një projekt shumë me rëndësi që krijon qasje të mirë për qytetarët e Ferizajt, me komunat përreth, regjionet përreth. Më vjen shumë mirë që më në fund janë kompletuar të gjitha procedurat e nevojshme për të filluar këtë projekt. E falënderoj BERZh-in dhe kompaninë që ka marrë përsipër ndërtimin e saj, si dhe ambasadorin italian që e kemi të pranishëm në shumë ngjarje të tilla, ku përmes kompanisë italiane po rritet prania e kompanive të BE-së përgjithësisht, që është në interes të madh për ne", ka thënë kryeministri Hoti.

Ai ka vlerësuar se është kompletuar projekti i cili i akomodon plotësisht nevojat e qytetarëve me nënkalimet e nevojshme për lëvizje të lirë për integrim të plotë të të gjitha lagjeve përreth këtij projekti, si dhe janë akomoduar edhe nevojat e bizneseve në mënyrë që ato të mos mbesin të izoluara për qasje në këtë infrastrukturë. "Duke parë seriozitetin e kompanisë, unë besoj se do të përfundojë në afat rekord. Ky është vetëm një nga disa projektet që financohen nga BERZh-i. Ministri i Infrastrukturës, Abrashi, ka një listë të gjatë projektesh që besoj se do t'i çojmë shpejt përpara, kryesisht me financim ndërkombëtar, duke marrë parasysh prioritetet që kemi në Kosovë edhe për fusha dhe sektorë të tjerë", ka thënë Hoti. Në ceremoninë e fillimit të punimeve për zgjerimin e rrugës në hyrje të qytetit të Ferizajt, bashkë me kryeministrin Hoti ishin edhe ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ambasadori i Italisë në Kosovë, Nicola Orlando dhe drejtori i BERZh-it në Kosovë, Neil Taylor. Ky projekt financohet nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) në vlerë prej 13 milionë e 407 mijë e 679,56 eurosh, me gjatësi prej 5.6 km.



# ATK-ja së shpejti me shërbimin për deklarimin e pasqyrave financiare

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

Prishtinë, 25 janar - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka njoftuar se së shpejti do ta ofrojë shërbimin e ri elektronik për deklarimin e pasqyrave financiare.

Sipas ATK-së, obligues për t'i deklaruar këto janë të gjithë tatimpaguesit, ashtu siç janë të kategorizuar me Ligjin për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim. "Shërbimi i ri elektronik, gjegjësisht deklarimi i Pasqyrave Financiare përmes Sistemit Elektronik EDI, do t'u kursejë kohë të gjithë tatimpaguesve, duke u mundësuar që deklarimin e pasqyrave financiare ta bëjnë në mënyrë elektronike dhe vetëm në një vend, pra në ATK, ndërsa KKRF do të pajiset me informatat e tilla nga ATK-ja. Pasqyrat financiare, për qëllime të ATK-së, do të deklarohen në periudhën dhe afatin kur dorëzohet edhe deklarata vjetore për tatim në të ardhura personale/korporata, pra nga data 1 janari deri më 31 mars të vitit pasues për vitin paraprak", thuhet në njoftim.




ATK-ja ka bërë me dije se do të njoftojnë me kohë për afatin e publikimit dhe mënyrën e deklarimit të pasqyrave financiare nëpërmjet sistemit elektronik EDI. "Sa iu përket të dhënave, se si duhet të plotësohen pasqyrat financiare, tatimpaguesit do të kenë mundësinë që t'u referohen mostrave dhe udhëzuesve që do të publikohen në Sistemin Elektronik EDI, gjegjësisht në menynë ku edhe do të paraqitet secila pasqyrë financiare veç e veç. Për afatin e publikimit dhe mënyrën e deklarimit të pasqyrave financiare nëpërmjet Sistemit Elektronik EDI do të njoftoheni me kohë", është thënë në njoftimin e ATK-së.

# Në Gjilan inaugurohet laboratori për Covid-19 me metodën RT-PCR



**Gjilan, 25 janar (ER)** - Ditë historike për Gjilanin e ka vlerësuar kryetari Lutfi Haziri inaugurimin e laboratorit për Covid-19 me metodën RT-PCR në Qendrën Rajonale të Shëndetit Publik (QRShP), në ngjarjen që mori pjesë edhe ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj dhe drejtori i Institutit Kombëtar i Shëndetësisë Publike, Naser Ramadani.
Haziri e ka falënderuar ministrin Zemaj për mbajtjen e premtimit për t'i sjellë në Gjilan këto shërbime. "Kjo është vizita e tretë e ministrit Zemaj në Gjilan, në kuadër të parandalimit të Covid-19 dhe jemi falënderues si institucione. Është ditë e jashtëzakonshme për Gjilanin sepse në kohë rekorde janë realizuar dy programe të mëdha, ky i laboratorit për Covid-19 me metodën RT-PCR dhe rezervuari i oksigjenit. Do ta vazhdojmë zbatimin e masave në mënyrë rigoroze derisa të hiqet pandemia. Do të vazhdojmë ta ruajmë shëndetin e popullatës nga Qendra Rajonale e Shëndetit Publik, duke përfshirë kontrollin e ujit, ushqimit dhe ajrit nga gardianët e shëndetit tonë", ka thënë Haziri.
Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se ndihet i lumtur që janë realizuar këto dy programe të rëndësishme për shëndetësinë në Gjilan.
Drejtori i IKShPK-së, Naser Ramadani, ka thënë se kjo është ditë historike për Gjilanin dhe rajonin, në mënyrë që qytetarët t'i kryejnë më lehtë dhe më shpejt shërbimet. Kurse drejtoresha e Qendrës Rajonale e Shëndetit Publik, Ajhane Sefiu, e ka falënderuar ministrin Zemaj, drejtorin Ramadani dhe kryetarin Haziri për mbështetjen e madhe për realizimin e këtij projekti të madh për testim me metodën RT-PCR.

# Hoxhaj jep raport për pasojat e reshjeve të fundit në lagjet e komuniteteve joshumicë në Gjakovë



**Gjakovë, 25 janar (ER)**- Është mbajtur të hënën mbledhja e radhës e Komitetit për Komunitete në Komunën e Gjakovës. Nga përfaqësuesit e Zyrës Komunale për Komunitete është prezantuar raporti mujor i aktiviteteve të kësaj zyre, ndërsa nga ana e drejtorit të Drejtorisë për Emergjenca, Vehat Hoxhaj, është raportuar për situatën e krijuar në lagjet e komuniteteve joshumicë si pasojë e reshjeve atmosferike javë më parë. Në këtë takim është shqyrtuar dhe miratuar edhe plani i punës së këtij komiteti për vitin 2021.

# Inspektorët komunalë në Mitrovicë kontrollojnë gjërat ushqimore në markete

**Mitrovicë, 25 janar (ER)** - Pas ankesave të shumta nga qytetarët, Drejtoria e Inspeksionit në Mitrovicë ka nisur aksionin në marketet e mëdha dhe te pemëshitësit për largimin e gështenjave nga tregu pasi që inspektorët komunalë me rastin e inspektimit në ato markete kanë vërtetuar që pjesa dërrmuese e gështenjave ishin të mykura dhe të krimbura, të cilat i kanë larguar pronarët e dyqaneve. Lidhur me këtë, drejtori i Inspeksionit, Fidan Ademi, ka falënderuar qytetarët për besimin dhe bashkëpunimin e mirë me institucionet gjegjëse, duke siguruar kështu që shëndeti i qytetarëve të jetë kryesor për të gjithë ne.



# Bulliqi dhe artistët llapjanë angazhohen t'i japin pamje më të bukur qytetit

**Podujevë, 25 janar (ER)** - Kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, me një grup artistësh dhe studentësh të arteve vizuale kanë vizituar disa zona të ndryshme në qytet, në mënyrë që të identifikohen objektet në të cilat duhet të intervenohet. Me këtë rast, kryetari Bulliqi dhe ekipi i artistëve që udhëhiqej nga profesori i artit, Faton Aliu, vizituan zonën përreth lumit Llap, hapësirat publike, objektet e banimit kolektiv dhe objekte të tjera publike në qytet, në mënyrë që të atyre t'u jepet një pamje më e bukur. Bulliqi ka thënë se ky grup do ta gëzojë përkrahjen e plotë të komunës, në mënyrë që, duke intervenuar në objekte dhe hapësira publike, qyteti i Podujevës nëpër të cilin kalon lumi dhe ka parkun e bulevardin, të marrë pamje sa më të bukur dhe joshëse për qytetarët llapjanë dhe vizitorët.



Aziz Kelmendi dhe enigma e vrasjeve pa luftë në kohë robërie (10)

# Paraburgimi i gjashtë shqiptarëve, një romi dhe një myslimani-boshnjak



Lulzim SAHITI

Pasi arritën të dalin të gjallë nga burgu të përvuajturit nga prangat e sistemit jugosllav janë munduar të dëshmojnë për ferrin e papërshkrueshëm, në të cilin kanë kaluar nëpër qelitë e përgjakura të burgut famëkeq të Nishit.

Rizah Xhakli: Më 7 shtator 1987 në Paraqin na mblodhën të gjithë ushtarëve shqiptarë. Pastaj, na futën në një autobus dhe na kanë dërguar në Nish. Atje na kanë shpërndarë nëpër kazerma të ndryshme. Mua më dërguan në një çetë, në Kazermën Ushtarake "Stefan Singjeliq" dhe sa herë që kishin nevojë për mua më ftonin te zyrat e oficerëve. Siç dihet mirëfilli, dita i ka 24 orë dhe mua mund të them lirisht prej datës 7 deri më 19 shtator 1987 më kanë marrë në pyetje 20 orë në ditë. Shpeshherë bukën ma sillnin në zyrë të tyre. Për këto dhjetë ditë nuk kam pasur asnjë maltretim fizik, por psikik kam pasur shumë. Aty afër ka qenë edhe burgu i vogël ushtarak, i cili ka pasur vetëm nëntë çeli. Një çeli ka qenë më e madhe, kurse tetë të tjera kanë qenë me nga një shtrat.

Më 19 shtator 1987 aty po i shoh disa oficerë të tjerë dhe policinë ushtarake. E mora me mend se do të më arrestojnë. Një oficer ma kumtoi arrestimin me zë të lartë duke më thënë: "Ngritu në këmbë, duart pas, kokën poshtë!" M'i lidhën duart, më shtynë dhe më futën në automjetin e tyre. Më kanë dërguar direkt te gjykatësi hetues, i cili ishte Marinko Radenkoviq, me gradë ushtarake kapiten i klasës së parë. Ka qenë pak para përfundimit të punës, diku rreth orës 16:00 dhe deri në ora 22:00 kam qenë te gjyqtari hetues. Më pyeste, por s'kisha çka t'i them. Më tha: "Kemi bërë masakër atje, e këtu nuk flet". Kur më dërguan për herë të parë te gjykatësi hetues, më pyeti se a dua mbrojtës. Nuk desha të pranoj, i thashë se nuk më duhet, sepse nuk jam fajtor. Gjykatësi më caktoi për mbrojtës zyrtar majorin Spaso Stojkovski nga Garnizoni i Kumanovës, i cili asnjëherë nuk e ka çelë gojën për të më mbrojtur nga akuzat. Më vonë, në fund të hetimeve më lejuan të kam mbrojtës civil avokatin Isa Mustafa nga Gjilani. Kah ora 22:00 më futën në qeli. Prej hetimeve e deri në fund të dhjetorit në pyetje më ka marrë inspektori ushtarak nënkolonel Ante Kojungjiq (kroat) dhe një procesmbajtës ka qenë me të. Pas katër-pesë dite që më dërguan në qelin nr. 4, në Burgun Ushtarak të Nishit, erdhi koloneli Aleksandar Vasiljeviq, një njeri civil me një fytyrë shumë të rreptë që asokohe unë nuk e njihja. Në qeli kemi pasur të drejtë t'i pimë vetëm 7 cigare brenda ditës. Ai, fillimisht më dha një cigare "Kent" të gjatë. Duke biseduar, më dha edhe një tjetër cigare. Kështu rrjedha e bisedës me të shkonte shumë qetë e mirë. Ai bisedonte vazhdimisht por nuk e dija se kush ishte ky njeri. Insistonte që unë të bashkëpunoj, të pranoj veprën me qëllim që të dënohem më pak. Nëse nuk bashkëpunoj ekziston mundësia t'i marrë 20 vjet burg, ekziston mundësia për të më pushkatuar por nëse pendohesh e gjëra të tilla mund të kaloj më lehtë. Unë nuk kam çka pendohem, i thashë troç këtij njeriu të panjohur që më vonë mora vesh se kishte qenë shefi i Shërbimit Kundër-Zbulim (Kontra-Obaveshtajna Sluzhba-KOS).

Filluan të më rrahin çdo ditë. Një ditë, një polic i cili quhej Zdravko Blazheviq nga Zagrebi më mbylli në WC dhe më tha se do të më rrahë çdo ditë deri sa të pranoj. Një ditë po ai më nxori në shëtitje dhe në fund të çdo rrethi më godiste me shufër gome duke thënë: "Këtë e ke nga Begiqi, këtë e ke nga Simiqi…" dhe ashtu për secilin ushtar të vrarë merrja nga një goditje…

Me vizitonin shpesh disa oficerë të lartë… më mbanin "fjalime", më kërcënonin më thonin se jam duke ia hapur vetës varrin. Deri sa më kanë marrë në pyetje inspektorët nuk kam pranuar asgjë (s'kisha çka të pranoja)… pastaj erdhi një gjykatës tjetër hetues majori Milorad Vukosav. Më mundonte, më detyronte të qëndroja gatitu me fytyrë nga dera, që të mos shikoja fotografinë e Titos… Më pyeti se kë e kam në familje, kur i thashë, ai ndërhyri më fjalët "E mjera nëna jote, dhe ajo do të qajë tërë jetën për ty sikur qajnë nënat e ushtarëve të vrarë". Një ditë tha se do të më ballafaqojë me shokët dhe me pyeti se a dua të më sjellë dhe do të më thonë "Rizah, ti e ke bërë këtë dhe duhesh të pendohesh". M'i dha deklaratat e shokëve me nënshkrimet e tyre, të cilët kishin folur për mua, por nuk besova, mendova se donte të më detyrojë t'i akuzoj edhe unë ata. Kërkova të më ballafaqojnë me Shefqet Paçarizin. Me shpien në dhomë tjetër, por në vend të Shefqetit ma ndezën televizorin me videorekorder ku paraqitet Shefqeti, foli duke më akuzuar. Pastaj u paraqitën fytyrat e Afrimit, Pajazitit… por pa zë… Gjykatësi hetues më tha se do të m'i sjellë nënat e ushtarëve të vrarë që të më shohin sa i vrazhdë jam, do t'iu them, ja ku është vrasësi i më të dashurve tuaj, do të lidhim që të dukesh vrasës i vërtet do të shohim çka do të thonë ata.

Për gjashtë muaj ditë, hetimet kanë qenë të rënda sepse kemi qenë në moshë të re. Maltretime fizike ka pasur shumë të këqija. Po çka është më rëndësi atje të gjitha ato të rrahura që i kam marrë mund të them që 90 për qind e të tyre i kam pasur nga gardianët dhe drejtori i burgut por jo nga hetuesit. Kur vinte drejtori i burgut, i cili quhej Stanko, për shembull nëse s'pranoja diçka çka nuk ka qenë, mirëpo u tregoja vetëm realitetin që s'kemi pas asgjë me rastin e Paraqinit dhe nuk jam bashkëpjesëmarrës i saj. Ata (gardianët) menjëherë reagonin duke i thënë drejtorit: "Çka u bë tash, nuk po flet ky!". Ai në prezencën e tyre, jo me të rrah me shufër por me grushta, shpulla e shqelma qysh kanë dashur ata. Bile një herë e di, zyrat kanë qenë afër burgut hetues, i ndante vetëm një hapësirë në mes dy objekteve. Një herë më ka goditur me shqelm prapa. Më ka qëlluar me këmbë në testise. Nga dhimbja e madhe, aty jam rrëzuar dhe kam humbur vetëdijen. Ndërkohë e kam parë vetën në qelinë time duke më hedhur ujë. Atëherë erdha në veti.



*Rizah Xhakli në pavijonin VII, në Burgun e Pozharevcit, gjatë vitit 1996. Ai nga burgu ishte liruar më 14 mars 2001 pasi kishte kaluar 13 vjet e pesë muaj e 25 ditë.*

Kështu ka ndodhur disa herë. Mandej, gardianët sa herë është hapur dera e qelisë na kanë rrahur. Kur është dashur me na rrahur më shumë, na ka rrahur drejtori me disa gardianë ose oficerë që nuk i njihja e jo ky i imi që e njihja. Ata kërkonin që unë të pranoj se jam marrë vesh me Rizo Alibashiqin që Aziz Kelmendit t'i jepen dy karikator municion. Të pranoj që kur ka ardhur Azizi pak para orës 3:00, të 3 shtatorit, më ka thirrur mua të parin dhe unë i kam thirr të tjerët ushtarë shqiptarë. Pastaj gjojase kemi dalë nga Kazerma dhe e kemi pritur Azizi deri sa e ka kryer aksionin. Dhe, në fund kinse jemi përshëndetur me të edhe më pastaj jemi kthyer në kazermë. Këto kanë qenë ato më tepër që kanë insistuar dhe që kanë qenë akuzat më të rënda për mua që më janë bërë. Rizo Alibashiqi disa ditë nuk ka pranuar, mandej ka pohuar ashtu siç ka kërkuar gjyqtari hetues. Gjithashtu, Islam Mahmuti bënte çka i thonin ata. Thoshte po Riza më ka thirrë mua, kemi dalë kështu…, Shefqet Paçarizi e Pajazit Aliu nga dhuna kishin pranuar çka kërkonte gjykatësi hetuesi por unë nuk e pranoja. Më kumtonin nenin, me të cilin unë akuzohem. Ishte neni 122, me të cilin fillimisht jemi akuzuar "për bashkim dhe veprimtari armiqësore" mirëpo pas një muaji është ndërruar aktakuza, ku e bënë: "Ndihmë në vrasje nga ndjenjat armiqësore kundër Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë". Me atë nenë minimumi i dënimit ishte 10 vjet, maksimumi pushkatim. Atë kohë, deri në vitin 1991 ka ekzistuar dënimi me vdekje. Pra, ata nuk na tregonin për një aline që kishte qenë, të cilën e kam kuptuar pasi më kanë dënuar, ku thoshte: "Nuk bëhet ekzekutimi me vdekje nëse i pandehuri në moshën kur e ka kryer veprën ka qenë nën moshën 23-vjeçare". Mua personalisht dhe Abdylxhemil Alimanin, të cilët kemi qenë dy të akuzuarit e parë, na ka shpëtuar vetëm mosha e re sepse përndryshe edhe pse kemi qenë të pafajshëm dhe të paorganizuar për t'i ndihmuar Azizit, qysh na kanë dënuar edhe e kemi mbajtur burgun, ne do të ishim të pushkatuar por fatbardhësisht ata e kanë respektuar Kushtetutën e tyre. Bënin trysni të madhe për të pranuar dokrra. Dikur kah fundi nuk më merrnin në pyetje, ndërruan taktikën filluan të mos vijnë shpesh por vinin çdo tri katër ditë ose pesë ditë. Me thënë të drejtën nisi të më kaploi një frikë sepse ekzistonte gjithmonë ai kërcënimi me vdekje. Tashmë isha lodhur në shpirt, erdhën njëherë dhe ju thash a dini çka krejt çka thoni ju unë kam për të nënshkruar veç le të përfundon kjo punë. Edhe krejt çka kanë pasur i kam nënshkruar të gjitha dhe pas një jave është caktuar data e fillimit të gjykimit tonë".

Abdylxhemil Alimani: "Pastaj pësoi transferimi i të gjithë ushtarëve nga kazerma, me arsyetimin se ushtarët janë të traumatizuar. Mua më transferuan në kazermën e Zajeçarit. Atje qëndrova tri ditë gjatë të cilave vazhdimisht më merrnin në pyetje. Edhe aty nuk munda të vërej se bëhet fjalë për një akuzë që do të më ngarkohet mua. Nga aty, pa më komunikuar arsyet, më transferuan në kazermën e Nishit. Edhe atje filluan të më marrin në pyetje. Nga ora 5 e mëngjesit deri në ora 24. Edhe pas mesnate. Mirëpo tash, në pyetjet që më bënin, më ngarkonin se së bashku me ushtarë tjerë shqiptarë të Paraqinit i kemi ndihmuar Azizit në vrasjen e ushtarëve, se kemi bërë veprimtari armiqësore kundër RSFJ-së, nga neni 114 dhe 136. Ende pa na marrë në pyetje gjykatësi hetues, inspektorët e sigurimit na i kishin caktuar edhe nenet. Edhe pse isha i lirë, unë tërë kohën e kaloja në zyrat e inspektorëve ushtarakë të sigurimit. Kjo zgjati gati 20 ditë, kur më 19 shtator 1987, të njëjtit inspektor që më sollën nga Zajeçari në Nish, më dërguan në Gjyqin Ushtarak në Nish ku gjykatësi hetues, kapiten i klasës të parë Marinko Radenkoviq më kumtoi lajmin se prej ditës së sotme jam i privuar nga liria dhe ngarkohem për veprimtari armiqësore kundër RSFJ-së.

Gjërat rridhnin ashtu si dëshironin ata të cilët gjithçka e kishin përgatitur. Fillimisht, na akuzonin vetëm për veprimtari armiqësore kundër RSFJ-së, duke mos na e veshur "ndihmën" dhënë Aziz Kelmendit. Gjatë hetuesisë dhe gjatë angazhimit të inspektorëve ushtarakë të cilët bënin "punë të palodhshme", pas katër muajve na ndërruan aktakuzën, duke na akuzuar për "vrasje nga gjendja armiqësore kundër RSFJ-së dhe "ndihmës në vrasje".

Atëherë filluan hetimet edhe më të rrepta, me marrje më të shpeshta në pyetje. Edhe pse ishim nën hetuesi, ku gjykatësi hetues na merrte në pyetje, këtij i ndihmonin edhe inspektorët, të cilët edhe më tej na merrnin në pyetje dhe na detyronin që ta pranojnë aktakuzën e hartuar nga ata. Madje edhe një kapiten shqiptar që quhej Xhavit Teneqja nga ana e Kaçanikut, gjatë hetuesisë më ka maltretuar në formë psikike. Gardianët dhe inspektorët e sigurimit ushtarak kanë përdorur edhe dhunën, na kanë torturuar psikikisht, na kanë fyer moralisht që të na detyrojnë ta pranojmë veprën e tyre. Duke mos e ndier veten fajtor nuk pranova që të më caktohet mbrojtës, as civil e as ushtarak. Natën e Vitit të Ri (31 dhjetor 1987) më ka ardhur në qeli ish-kreu i Shërbimit Kundër-Zbulim të Ushtrisë Jugosllave, koloneli Aleksandar Vasiljeviq, i cili më tha: "Me veprimet e tuaja e ke rënduar vetën tënde. Po të kishe pranuar veprën do ta kishe shumë më lehtë!" Nuk kisha çka të pranoj sepse në natën kritike askujt nuk i kisha ndihmuar asgjë.

Gjatë kohës së marrjes në pyetje nga ana e gjykatësit hetues deklarova se nuk dëshiroj mbrojtës, mirëpo familja e shqetësuar me rastin tim, autorizon Sava Kocarev-in, avokat nga Shkupi. Por, atij nuk iu mundësua të takohet me mua dhe nuk i është mundësuar ta shqyrtojë mirë lëndën, me arsyetim se "Rasi i Paraqinit" është fshehtësi ushtarake. Pas refuzimit të ankesës së tij, mua më caktojnë një mbrojtës ushtarak, Argir Grebernakov i cili më tepër kryente punën e prokurorit se sa të mbrojtësit. Vetëm sa nuk më mundonte fizikisht.

Vetëm falë shtypjes së mjeteve të informacionit në gjuhën sllovene që gjykimi të jetë i hapur, kreu ushtarak një javë para fillimit, u detyrua që të lejojë të na mbrojnë avokatë civilë, të cilët për aq pak kohë nuk kanë mundur ta rishqyrtojnë gjithë lëndën voluminoze dhe me shumë dëshmitarë të ushtruar që të flasin kundër nesh. **(Vijon)**

# Kosova ka nevojë për lidership të pjekur shtetëror, jo për feude politike

Një pyetje që shtrohet jo vetëm para këtyre zgjedhjeve, por edhe në të gjitha rastet e tjera kur elitat partiake zhvillojnë beteja politike që si synim përfundimtar kanë marrjen e pushtetit, është se sa kemi arritur ne si Kosovë të krijojmë vetëdije shtetërore, e cila do të ishte rezistuese ndaj tundimeve që vijnë nga lufta për pushtet?



Nga Mehmet PRISHTINA

Demokracitë e konsoliduara nuk janë gjë tjetër pos drejtpeshim në mes të pasioneve të pushtetit dhe shenjtërisë së shtetit. Madje edhe atëherë kur një shtet hyn në luftë me një shtet tjetër, bien pushtetet dhe ngrihen shtabe emergjente kombëtare në të cilët përfshihen dhe shkrihen të gjithë faktorët politikë, ushtarakë e shoqërorë. Pra, epërsia që ka shteti, si nocion juridik e organizativ, ndaj pushtetit, si konjukturë politiko-partiake, shpreh më së miri rëndësinë dhe qenësinë e ekzistimit të shtetit në ruajtjen e mirëqenies së një kombi.

Për të ilustruar më së miri raportin në mes të shtetit dhe pushtetit, mund t'u referohemi ngjarjeve të 6 janarit në ShBA. Një grup protestuesish të dhunshëm, të frymëzuar nga retorika militariste e ish-presidentit Trump, sulmuan Kapitol Hillin dhe deshën ta imponojnë logjikën arbitrare puçiste të kontrolluar nga kasta e njerëzve në pushtet. Mirëpo, Kongresi, Pentagoni, gjykatat, policia, dëshmuan se në Amerikë pushtetet mund të ndërrohen në katër apo tetë vjet, por shtyllat kryesore të shtetit ngelin të palëkundur.

Mbi këtë parim u zhvillua dhe u ruajt demokracia amerikane, kurse ata që personifikojnë këtë demokraci janë gardianët e shtetit në mesin e kongresistëve, oficerëve, ushtarëve, policëve, gjyqtarëve e administratorëve të ndryshëm.

Në demokracitë që ende nuk i kanë kaluar të gjitha fazat e zhvillimit dhe strukturimit të brendshëm, jo rrallë ndodh që pushtetet të dalin mbi shtetin dhe të bëjnë njëfarë monopolizimi dhe zaptimi të lirive të njerëzve, të resurseve ekonomike e industriale si dhe, mbi të gjitha, ta deformojnë kuptimin e pjesëmarrjes së njerëzve në proceset zgjedhore. Në këto lloj shoqërish pushtet përdoron për ta instrumentalizuar shtetin për nevoja të oligarkive të caktuara politike-ekonomike, ku sistemi i drejtësisë, i shëndetësisë dhe i arsimit janë atribute që shërbejnë si dekore për ta zbukuruar Kushtetutën dhe ligjet të cilat nuk zbatohen.

Pushtetet e tilla ndryshe quhen autokratike, kurse të gjithë ata që guxojnë t'i kritikojnë këto pushtete akuzohen se janë kundër shtetit (!).

Kosova edhe pak javë ndodhet në një fazë parazgjedhore. Më 14 shkurt sërish do të ketë zgjedhje të parakohshme dhe sërish do të garohet për marrjen e pushtetit përmes votës së lirë.

Një pyetje që shtrohet, jo vetëm para këtyre zgjedhjeve, por edhe në të gjitha rastet e tjera kur elitat partiake zhvillojnë beteja politike që si synim përfundimtar kanë marrjen e pushtetit, është se sa kemi arritur ne si Kosovë të krijojmë vetëdije shtetërore, e cila do të ishte rezistuese ndaj tundimeve që vijnë nga lufta për pushtet?

Sigurisht që Amerika është larg, edhe si gjeografi, edhe si kontekst civilizues, por minimumi i asaj që do të duhej të ndodhte në Kosovë, do të ishte përvetësimi i praktikave dhe njohurive mbi menaxhimin e shtetit nga ana e stafit ndërkombëtar, sidomos nga amerikanët, që janë të pranishëm te ne tash e njëzetë vjet. Çdo shtet që do ta kishte pasur këtë prani ndërkombëtare, do të quhej i privilegjuar, aq më tepër kur resurset dhe dijet e ekspertëve e administratorëve ndërkombëtarë, kemi mundur t'i përvetësojmë pa ndonjë investim shtesë nga ana e buxhetit të shtetit tonë. Ka mjaftuar një sens më i zhvilluar i kulturës dhe formimit shtetëror që Kosova të bëhet model i funksionimit të kapaciteteve ligjzbatuese, në favor të zhvillimit dhe prosperimit të përgjithshëm shoqëror.

Nuk mjafton të themi "jemi me Amerikën", ndërkohë që fare pak mësojmë nga Amerika. Ne mësojmë pak, madje edhe atëherë kur Amerika me sukses i tejkalon krizat e çastit, siç ishin trazirat e 6 janarit në Kapitol Hill. Atje shteti vazhdoi ta bëjë punën e vet, kurse pushtetet e bënë pranim-dorëzimin pa ndonjë ngërç të sforcuar. I humburi gjithmonë ka të drejtë të ankohet në rrugë ligjore, për ndonjë padrejtësi eventuale, por ai asnjëherë nuk mund ta dhunojë procesin e tranzicionit të pushteteve.

Kështu ndodh në Amerikë dhe kështu, përafërsisht, do të duhej të ndodhte edhe në Kosovën tonë. Kjo gjithsesi është aktuale tani në prag të zgjedhjeve të 14 shkurtit, kur institucionet, administrata dhe sistemi i drejtësisë do të duhej të ngelin të paprekura nga virusi i betejave politike. Zaten, ky është ideali i çdo shoqërie demokratike, pa të cilën nuk kanë kuptim fitoret në zgjedhje dhe pushtetet që dalin pas zgjedhjeve.

Polemikat e debatet e shumta që po ndodhin aktualisht në Kosovë, ku ka një kryqëzim interesash shtetërore e kushtetore, nuk po krijojnë ambient të nevojshëm për një masë kritike e cila do të dinte ta orientonte vëmendjen e publikut në çështje që janë me interes jetik për të sotmen dhe të ardhmen e Kosovës.

Në vend të debateve e polemikave inerte e kontraproduktive, që nuk ofrojnë kurrfarë vizioni, shoqëria e Kosovës ka nevojë për artikulim të ideve që nxisin shtigje të reja zhvillimi. Ka plot shembuj në botë që flasin për modele të ndryshme që përcaktojnë këto shtigje zhvillimi siç është, bie fjala, përfshirja e mërgatës sonë, me të gjitha resurset njerëzore e financiare në konsolidimin social e ekonomik të shtetit.

Pa dashur t'i relativizojmë dhe anashkalojmë resurset e brendshme, mërgata jonë ka dëshmuar se ka brenda vetes kuadro që me sukses menaxhojnë korporata, banka e spitale në vendet ku ata jetojnë e punojnë. Një elitë e mirëfilltë shtetërore do t'i angazhonte këta kuadro, siç bëri udhëheqja maqedonase në Shkup, në fillim të viteve nëntëdhjeta, e cila e ftoi mjekun Zhan Mitrev nga Gjermania dhe ia ofroi të gjitha kushtet për të instaluar një spital modern kryeqytetin e Maqedonisë.

Për ironi të fatit, qindra kosovarë iu kanë drejtuar për shërbime mjekësore pikërisht këtij spitali dhe çdo kryeministër që merr mandatin në Kosovë, do të duhej ta eliminonte nga koka e njerëzve epërsinë e maqedonasve në menaxhimin e shëndetësisë. Nëse nuk e bën këtë, ai kryeministër është një punonjës i rëndomtë i administratës, i cili edhe familjarët e vet i dërgon në spitalet e huaja për shërim.

Këtë shkrim do të doja ta përfundoj sërish me një pasus mbi Amerikën. Tani në Uashington ka një administratë të re dhe pritjet tona si Kosovë nuk duhet të bazohen shumë në skemat stereotipa se kush është me ne, e kush kundër nesh. Shumëçka do të varet nga sjelljet tona, si lidership dhe si shoqëri. Respekti dhe dashamirësia e miqve kultivohet gjithmonë kur arsyetojmë besimin e tyre ndaj nesh, por sidomos kur interesat tona si shtet i vendosim mbi pushtetet. Raportet e mira me Uashingtonin, Brukselin, Berlinin etj. ndërtohen duke çmuar kontributin e miqve tanë në procesin e shtetndërtimit të Kosovës, mirëpo miqtë tanë do të na vlerësonin më tepër kur fillojmë të mendojmë jo si prijës feudesh politike, por si lidership i pjekur shtetëror.




Rrallëherë ndodh qe lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtarie filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.
Zymber Kelmendi
***
Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzegjezë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.
Kristë Shtufi
***
Një libër që zbërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve te shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.
Fadil Sahiti
***
... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...
Orhan Kerkezi
***
Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.
Daut Dauti
ISBN 978-9951-780-37-7
ÇMIMI: 5.99 €
AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLOWSKI
ARMAGEDONI
AGRON SHALA
DEKALOGU
nga Moisiu deri te Kieślowski


Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjistruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.
Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve Bota e re, pastaj në revistën Zëri. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i Zërit nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.
Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan Kettering Foundation ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiues i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.
Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.
Një palë këpucë në Berlin është novela e tij e parë.
ISBN 978-9951-780-10-0
4.99 €
Daut Dauti • NJË PALË KËPUCË NË BERLIN
Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN
novelë
ARMAGEDONI




Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

# Ministrja Dumoshi: Në stadiumin 'Ramiz Sadiku' do të investohen rreth 200 mijë euro

"Ne po fillojmë punimet, drenazhimin, i cili ka qenë i nevojshëm që shumë kohë. Do të përpiqemi që këtyre gjeneratave të reja, këtyre talentëve, t'u japim mundësi që, së paku, infrastrukturën ta kenë, se këta janë ardhmëria jonë. Investimi është 200 mijë euro", ka thënë Vlora Dumoshi



PRISHTINË, 25 JANAR - Në kuadër të investimeve në infrastrukturën sportive, të hënën kanë filluar punimet edhe në stadiumin e "Ramiz Sadiku"-t në Prishtinë, në të cilin do të bëhet vendosja e drenazhit dhe e barit sintetik. Në fillimin e këtyre punimeve morën pjesë kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti dhe ministrja në detyrë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi. Me këtë rast, Dumoshi ka thënë se investimi dhe fillimi i punimeve në këtë stadium ka qenë shumë i nevojshëm dhe se në këtë projekt do të investohen rreth 200 mijë euro. "Erdhëm tani te klubi 'Ramiz Sadiku' i cili është një shkollë shumë e veçantë. Po i shohim të gjithë këta fëmijë. Rreth 200 anëtarë i ka prej grupmoshave të ndryshme. Ky është një lajm i mirë për Kosovën sepse kushtet për këto gjenerata të reja Qeveria e Kosovës është duke i financuar. Ne po fillojmë punimet për drenazhimin i cili ka qenë i nevojshëm që shumë kohë. Do të përpiqemi që këtyre gjeneratave të reja, këtyre talentëve, t'u japim mundësi që së paku infrastrukturën ta kenë, se këta janë ardhmëria jonë. Investimi është diku 200 mijë euro", ka thënë Dumoshi.

Ndërsa kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, theksoi se ky projekt është në vazhdën e investimeve të shumta që po bëhen në infrastrukturën sportive në nivel vendi dhe se kjo do të ndikojë në integrimin e sportit si dhe krijimin e kushteve për rritjen e talentëve të rinj. "Më vjen mirë që gradualisht po krijohen të gjitha kushtet e nevojshme që talentët t'i kryejnë trajnimet e nevojshme dhe të integrohet sporti prej shkollës e deri në karrierën e mëvonshme. Përgëzoj klubin këtu, federatën për këtë mbështetje dhe bashkëpunimin e nevojshëm që të krijojmë këto kushte këtu dhe në të gjitha stadiumet e tjera. Ne sapo ishim në një stadium tjetër në anën tjetër të Prishtinës, edhe atje po kompletohen dhe besoj se e gjithë infrastruktura e nevojshme brenda vitit të përfundojë në mënyrë që të kenë mundësi të gjitha moshat t'i kryejnë trajnimet e tyre edhe lojërat dhe garat që i kryejnë në kuadër të sportit", ka deklaruar Hoti.

Kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti dhe ministrja në detyrë e sportit, Vlora Dumoshi, të hënën morën pjesë edhe në fillimin e punimeve në stadiumin e Klubit të Futbollit "2 Korriku".

## SHKURT

### Rashani transferohet te Erzurumspori

Sulmuesi i Përfaqësueses së Kosovës, Elbasan Rashani, edhe zyrtarisht është lojtar i skuadrës turke, Erzurumspor. Rashani ishte pjesë e skuadrës norvegjeze Odd, ku kishte regjistruar 92 paraqitje dhe kishte shënuar 15 gola. Rashani ka nënshkruar kontratë për një vit e gjysmë me skuadrën turke dhe do të bashkohet menjëherë me skuadrën. Lajmin për transferimin e tij e ka bërë me dije skuadra përmes një postimi në rrjetin social "Twitter". Për Kosovën, Rashani ka regjistruar 18 paraqitje dhe ka shënuar katër gola.

### Llapi fiton edhe një ndeshje miqësore

Skuadra e Llapit ka vazhduar ndeshjet e mira kontrolluese në Antalia të Turqisë, ku po kryen fazën përgatitore. Skuadra e drejtuar nga trajneri Tahir Batatina shënoi fitore me rezultat 2-0 ndaj ekipit ukrainas Obolon. Shënuesit e llapjanëve në këtë ndeshje ishin Edon Sadriu dhe Kastriot Selmani. Portieri i Llapit ndali një penallti në minutën e 31-të.

### Ministri i Jashtëm i Spanjës flet për ndeshjen Spanjë - Kosovë

Rruga për në Kupën e Botës 2022 ka vendosur përballë njëra-tjetrës Kosovën dhe Spanjën. Spanja është një nga vendet që ende nuk e ka njohur Kosovën si shtet dhe ishte raportuar se kjo mund të çojë në një konflikt diplomatik, por që ministri i Jashtëm i Spanjës, Arancha Gonzalez Laya, e ka hedhur poshtë, përcjell "KosovaPress". "Edhe pse Spanja nuk e njeh Kosovën shtet i pavarur, nuk do të thotë që Spanja nuk merr pjesë në turne në të cilat merr pjesë Kosova. Në këtë mënyrë, pozicioni zyrtar i qeverisë së vendit tonë përballë kësaj situate delikate ishte i qartë, duke diferencuar çështjen e sportit nga politika", ka thënë ai. Laya ka kërkuar që kjo çështje të zgjidhet me rregullat e FIFA-s të cilat nuk duhet të përkojnë me ato të së drejtës ndërkombëtare.

### Hysenagolli, MVP i xhiros 17

Në fundjavë u zhvillua xhiroja e 17-të në Superligën e Kosovës në basketboll. Në bazë të indeksit, basketbollisti më i mirë i javës së 17-të është zgjedhur qendra e Bashkimit dhe Kombëtares Shqiptare, Endrit Hysenagolli. Ai ndaj Vëllaznimit shënoi 20 pikë, kishte edhe 17 kërcime dhe dy asistime, derisa indeksin e lojës e kishte 33. Hysenagolli u përballë me qendrën e Vëllaznimit, Emmanuel Omogbo, i cili zhvilloi një ndeshje të mirë. Që nga transferimi në Bashkim, Hysenagolli ka zhvilluar ndeshje të mira, kurse kjo është hera e parë që shpallet MVP i xhiros në Superligën e Kosovës në basketboll. Ndërkohë, top pesë basketbollistët me indeksin më të lartë në xhiron e 17 janë: Emmanuel Omogbo i Vëllaznimit 33, Endrit Hysenagolli i Bashkimit 33, Brandon Walter i Pejës 29, Dion Dixon i Pejës 27 dhe Isaiah Traylor i Rahovecit 26.

## KB Ylli, organizator i Final 8 i Kupës së Kosovës

Prishtinë, 25 janar - Bordi i Federatës i Basketbollit të Kosovës ka marrë vendim që skuadra e Yllit nga Suhareka të jetë organizatore e Final 8 të Kupës së Kosovës në basketboll. Ky vendim ka ardhur pasi KB Rahoveci është tërhequr nga organizimi i Final 8 i Kupës së Kosovës. "Bordi i Federatës i Basketbollit të Kosovës (FBK) ka marrë vendim që KB Golden Eagle Ylli nga Suhareka të jetë organizator i Final 8 i Kupës së Kosovës në datat 3-7.02.2021. Pas njoftimit nga KB Rahoveci për tërheqje nga organizimi i Final 8, interesim për organizimin e kësaj ngjarje prestigjioze ka shprehur KB Golden Eagle Ylli nga Suhareka dhe pas votimit nëpërmjet deklarimit elektronik të anëtarëve të Bordit të FBK-së konform nenit 6, alineja B e Rregullores së Punës së Bordit të FBK-së, KB Golden Eagle Ylli është shpallur organizator i Final 8. Vendimi hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij", thuhet në njoftimin e FBK-së.



## Chelsea shkarkon Lampardin, Tucheli pritet të emërohet trajner i ri



**Londër, 25 janar** - Frank Lampardi zyrtarisht nuk është më trajner i Chelseat. Ish-mesfushori, një legjendë në klubin blu, e drejtonte skuadrën prej korrikut të vitit 2019. Ai u shkarkua për shkak të rezultateve. "Blutë e Londrës" renditen në vendin e nëntë pas 19 javësh kampionat. "Chelsea ka ndërprerë bashkëpunimin me trajnerin Frank Lampard. Ky ka qenë një vendim i vështirë. Nuk ishte e lehtë për bordin dhe presidentin të vendosnin. I jemi mirënjohës Frankut për punën e bërë, por rezultatet dhe paraqitjet e fundit nuk janë ato që klubi pret. Pozicionimi në mes të tabelës, pa ndonjë rrugë të qartë për t'u përmirësuar, nuk është ajo që pritet. Kurrë nuk është një moment i mirë të ndahesh me një legjendë si Frank", ka njoftuar Chelsea që është marrë vesh me Thomas Tuchelin dhe pritet ta zyrtarizojë.

# Hasani: KON-i është i vendosur që të mbahen Lojëra Olimpike

**Prishtinë, 25 janar** - Presidenti i Komitetit Olimpik i Kosovës (KOK), Besim Hasani, ka marrë pjesë në video-konferencën e presidentit të Komitetit Olimpik Ndërkombëtar (KON), Thomas Bach, kur kanë mbetur edhe gjashtë muaj deri në Lojërat Olimpike Tokio 2020. "Presidenti Hasani deklaroi se i pari i Lëvizjes Olimpike në botë, Thomas Bach, i siguroi presidentët e KO se bashkë me qeverinë e Japonisë dhe anëtarë të tjerë të KON-it janë të vendosur që këto lojëra të mbahen në kohën e paraparë dhe të jenë të sigurta për të gjithë pjesëmarrësit", thuhet në njoftimin e KOK-ut.



Presidenti Bach theksoi se në ditët e ardhshme do të bisedojë edhe me komunitetin e sportistëve në mënyrë që më 23 korrik, në ceremoninë hapëse, ta dërgojnë bashkërisht në mbarë botën mesazhin e solidaritetit dhe paqes. Bach foli edhe për masat që do të merren për mbrojtje nga pandemia Covid 19, për çka tha se janë duke u përgatitur të gjithë skenarët e mundshëm si: pjesëmarrja e një numri të caktuar të tifozëve, rregullat e karantinimit, distanca, testimi, vaksinimi, jeta në Fshatin Olimpik etj. Edhe Komiteti Olimpik i Kosovës është duke u përgatitur në mënyrë që në LO Tokio 2020 të marrë pjesë me numër sa më të madh të sportistëve, për çka së fundi ka shtuar mbështetjen ndaj sportistëve elitarë, të cilëve do t'u hiqen shpenzimet e përgatitjeve deri në 80 ditë brenda gjashtë muajve, si dhe heqjen e shpenzimeve të një gare ndërkombëtare të vlefshme për pikë olimpike. Deri më tani, KOK ka një normë olimpike me mundësin Egzon Shala dhe pesë norma që pritet të konfirmohen edhe zyrtarisht për sportistët e xhudos, Majlinda Kelmendi, Distria Krasniqi, Nora Gjakova, Loriana Kuka e Akil Gjakova, që do ta çojnë në gjashtë numrin e normave olimpike. Lojërat Olimpike Verore mbahen në Tokio të Japonisë prej 23 korrik - 8 gusht 2021.

# Clippersat regjistrojnë fitoren e shtatë radhazi

**Los Anxhelos, 25 janar** - Los Angeles Clippers ka regjistruar një tjetër fitore në NBA, të shtatën radhazi. Skuadra nga Kalifornia ka triumfuar në "Staples Center" përballë Oklahoma City Thunder me tetë pikë diferencë 108-100. Kawhi Leonard ka qenë më i merituari për këtë fitore me 34 pikë, nëntë kërcime e tetë asistime. Pas amerikanit, më efikasi ishte Serge Ibaka me 17 pikë, kurse me pikë dyshifrore ndeshjen e mbyllën edhe Jacksoni, Paul George dhe Ivica Zubaq. Gilgeous-Alexander me 23 pikë dhe Hilli me 22 të tjera ishin më efikasit te mysafirët, por që nuk mjaftuan për fitore. Me fitoren ndaj OKC, Clippersat ngjitën në krye të tabelës së bashku me rivalin lokal Lakers me nga 13 fitore e katër disfata. Në anën tjetër, Oklahoma City Thunderi ndodhet në vendin e 12-të në Konferencën e Perëndimit me gjashtë fitore e nëntë humbje. Ndeshjen e radhës Clippersat e zhvillojnë në udhëtim tek Atlanta Hawksi, kurse OKC luan te Portland Trail Blazersi.




**REZULTATET**

| | |
|---|---|
| Indiana Pacers - Toronto Raptors | 102-107 |
| LA Clippers - Oklahoma City Thunder | 108-100 |
| Boston Celtics - Cleveland Cavaliers | 141-103 |
| Orlando Magic - Charlotte Hornets | 104-107 |
| Milwaukee Bucks - Atlanta Hawks | 129-115 |
| San Antonio Spurs - Washington Wizards | 121-101 |
| Portland Trail Blazers - New York Knicks | 116-113 |

## SHKURT

### Gattuso rrezikon shkarkimin, Benitezi mund të rikthehet te Napoli

Humbja nga Verona (3-1) nuk i ka pëlqyer aspak presidentit të Napolit, Aurelio De Laurentis. Ky i fundit ka filluar të mendojë për zëvendësuesin e Rino Gattusos. Mediat italiane raportojnë se Rafa Benitezi mund të jetë trajner i ri i skuadrës së Napolit. Tekniku spanjoll e ka drejtuar Napolin në vitet 2013-2015. Aktualisht skuadra e Napolit zë vendin e gjashtë me 34 pikë.

### Presidenti i Atleticos: Suarezi është sulmuesi më i mirë në Evropë

Presidenti i Atletico Madridit, Enrique Cerezo, e ka lavdëruar sulmuesin Luis Suarez i cili ka shënuar edhe në ndeshjen e fundit kundër Valencias. "Ne gjithmonë kemi menduar se Luis Suarezi ishte qendërsulmuesi më i mirë në Evropë dhe jemi me fat që ai është me ne", ka thënë Cerezo.

### Paredes: PSG-ja po përpiqet ta transferojë Messin

Paris Saint-Germain është duke bërë përpjekje ta transferojë Lionel Messin, por i takon lojtarit të vendosë, ka konfirmuar Leandro Paredes, ylli argjentinas i klubit francez. Kampioni francez është ndër klubet e pakta që mund ta përballojnë afrimin e sulmuesit dhe kapitenit të Barcelonës, marrëveshja e të cilit me katalonasit mbaron në fund të këtij sezoni. Emërimi i Mauricio Pochetinos në postin e trajnerit në "Parc des Princes" i ka nxitur edhe më shumë thashethemet për kalimin e Messit në PSG. Duke folur për bashkëkombësin e vet, Paredes ka deklaruar: "I takon Messit të vendosë se a dëshiron të vijë, sepse PSG-ja po përpiqet ta bindë atë. Të jesh në gjendje të luash nën urdhrat e një trajneri nga vendi yt dhe ta kesh mundësinë të luash me Leon është mundësi e madhe. Shpresoj se do të ndodhë". Përveç se do të bashkohej me bashkatdhetarët e vet Angel Di Maria, Paredes dhe Pochettino, Messi do të ribashkohej edhe me Neymarin.

### Bayerni piketon Torresin si zëvendësues i Alabas

Mbrojtësi i Bayern Munchenit, David Alaba, është pothuajse i larguar nga "bavarezët". Austriaku është një hap larg transferimit te Real Madridi dhe marrëveshja pritet të zyrtarizohet këtë javë. Megjithatë, gjermanët nuk kanë humbur aspak kohë dhe e kanë piketuar menjëherë zëvendësuesin e tij. Sipas raportimit të "Sport 1", i përzgjedhuri i Bayernit është mbrojtësi i Villarealit, Pau Torres. Kartoni i Torres kushton plot 60 milionë euro.

### Italia, afër përjashtimit nga Olimpiada e Tokios

Italia drejt përjashtimit nga Lojërat Olimpike të Tokios. Ky është vendimi i CIO-s (Komiteti Olimpik Ndërkombëtar) që pritet të zyrtarizohet të mërkurën në orën 17:30. Nëse nuk do të dekretohet ligji që zgjidh autonominë e CONI-t (Komiteti Olimpik Kombëtar Italian), Italia do të bëjë një figurë vërtet të keqe. Sportistë si Federica Pellegrini apo Gregoria Paltrinieiri, mjafton të përmenden dy, do të mund të garojnë në ngjarjen më të madhe sportive të vitit si të pavarur, pra jo me siglën e një shteti (pa flamur dhe himn), sikurse i ndodhi Bjellorusisë së Llukashenkos apo Rusisë, që u përfshi në skandalin e dopingut. Do të ishte një figurë qesharake e vendit përtej Adriatikut edhe në këndvështrimin e Lojërave Olimpike Dimërorë Milano-Cortina 2026, që do të thotë se do të ndërpriten edhe financimet e CIO-s në Itali. Me një fjalë, situata është shumë delikate dhe vetëm qeveria italiane mund ta zhbllokojë "in extemis", pasi Lozana e ka bërë të qartë: ka gati vendimin për përjashtimin e Italisë nga Olimpiada. Është një rast politik i papredecent, duke qenë se dekreti për dhënien e autonomisë CONI-t është gati, por që ka mbetur thjesht për t'u aprovuar.

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të Vendimit për zbatimin e Planit të Rekrutimit të Punonjësve për vitin 2021, si dhe duke pasur parasysh nenin 6 të Rregullores Nr.03/2020 për Marrëdhënie Pune në Zyrën Kombëtare të Auditimit, me datën 26 janar 2021, shpallet:

## KONKURS
## për plotësimin e vendit të punës

| | |
|---|---|
| **I. Pozita:** | **"Zyrtar ligjor"** |
| Kodi: | ZL/ZKA/01-01/21 |
| Grada: | ZKA/K-08 |
| Numri i pozitave: | Një (1) |
| Kohëzgjatja: | Me kohë të pacaktuar |
| Periudha provuese: | Një (1) vit |
| Zyrtari mbikëqyrës: | Drejtori i Përgjithshëm Administrativ |

Vendi i punës është në selinë e Zyrës Kombëtare të Auditimit në Prishtinë.

**II. Detyrat dhe përgjegjësitë themelore**
- Përkrahja e drejtpërdrejt profesionale e Drejtorit të Përgjithshëm Administrativ në çështjet ligjore dhe administrative;
- Ndihmon në përgatitjen e planeve të punës për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të shërbimeve të përgjithshme administrative dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e tyre;
- Merr pjesë në hartimin dhe zhvillimin e projekt akteve juridike, vendimeve, kontratave, marrëveshjeve dhe akteve nga fushëveprimtaria administrative e ZKA-së;
- Bën hulumtime dhe analiza që ndërlidhën me ligjet dhe aktet nënligjore brenda fushës së përgjegjësisë në shërbimet e përgjithshme administrative, përgatitë opinione ligjore dhe jep rekomandime, këshilla dhe udhëzime për Drejtorin e Përgjithshëm Admininistriv;

Përshkrimin e detyrave, së bashku me këtë konkurs e gjeni në faqen e internetit të ZKA-së "Mundësi Punësimi".

**Kualifikimet e kërkuara:**
- Fakulteti përkatës;
- Përvojë pune profesionale prej dy (2) vitesh;

**Shkathtësitë e kërkuara:**
- Njohuri dhe përvojë në hartimin, harmonizimin e legjislacionit dhe akteve tjera juridike;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme në sistemin publik të ndërlidhura me shërbimet administrative të ZKA-së;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion kohor dhe diversitet profesional;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internetit).

**<u>Procedura e Konkurrimit:</u>**
Formularin e konkurrimit kandidatët mund ta marrin në recepcionin e objektit të Zyrës Kombëtare të Auditimit ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën: www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin e Burimeve Njerëzore në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari konkurrues dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1005.

**Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme:**
- Formularin zyrtar të ZKA-së për konkurrim;
- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Kopjet e diplomave për kualifikimet shkollore. Diplomat e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- Kopjet e kualifikimeve të tjera profesionale që lidhen me pozitën e punës;
- Dëshmitë për përvojën e punës të lëshuara nga organizata përkatëse – punëdhënësi;
- Dëshminë se nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale me dashje.

Vetëm formulari zyrtar i konkurrimit do të merret parasysh. Formularët e konkurrimit të dorëzuar pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen, kurse formularët e pakompletuar do të refuzohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të informohen. Gjithashtu kandidatët të cilët nuk i plotësojnë kushtet do të njoftohen se nuk janë përzgjedhur t'i nënshtrohen procedurës së punësimit.
Konkursi është i hapur 15 ditë, pas ditës së publikimit në mediat e shkruara dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit, duke filluar nga data 26.01.2021, kurse afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data 10.02.2021, ora 16.00.

**Shënim:**
Formularët e konkurrimit dhe dokumentet e dërguara me postë, të cilët mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për konkurrim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda tri (3) ditësh. Formularët që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara me dokumentacionin përkatëse nuk do të shqyrtohen.

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U skladu sa Odlukom za sprovođenje Plana Zapošljavanja Radnika za 2021. godinu i uzimajući u obzir član 6. Pravilnika Br.03/2020 o Radnom Odnosu u Nacionalnoj Kancelariji Revizije, dana 26 Januara 2021, objavljuje se:

## KONKURS
## za popunjavanje radnog mesta

| | |
|---|---|
| **I. Pozicija:** | **"Pravni službenik"** |
| Kod: | ZL/ZKA/01-01/21 |
| Nivo: | ZKA /K-08 |
| Broj pozicija: | Jedna(1) |
| Trajanje: | Na neodređeno vreme |
| Probni period: | Jedna (1) godina |
| Nadzorni službenik: | Generalni Administrativni Direktor |

Radno mesto je u sedište Nacionalne Kancelarije Revizije u Prištini.

**II. Osnovne dužnosti i odgovornosti**
- Direktna profesionalna podrška Generalnog Administrativnog Direktora u pravnim i administrativnim pitanjima;
- Pomaže u pripremi planova rada za sprovođenje zadataka definisanih na osnovu ciljeva opštih administrativnih usluga i daje preporuke u vezi sa njihovom realizacijom;
- Učestvuje u izradi i izradi nacrt pravnih akata, odluka, ugovora, sporazuma i akata iz administrativnog delokruga NKR-a;
- Sprovodi istraživanja i analize koje se povezuju sa zakonima i podzakonskim aktima iz delokruga odgovornosti opštih administrativnih usluga, priprema pravna mišljenja i daje preporuke, savete i uputstva Generalnom Administrativnom Direktoru;

Opis zadataka, zajedno sa ovim konkursom, možete naći na veb stranici NKR „Mogućnosti zapošljavanja".

**Potrebne kvalifikacije:**
- Relevantni fakultet;
- Profesionalno radno iskustvo od dve (2) godine;

**Potrebne veštine:**
- Znanje i iskustvo u izradi, usklađivanju zakonodavstva i drugih pravnih akata;
- Poznavanje važećih zakona i propisa u javnom sistemu koji se odnose na Administrativne usluge NKR-a;
- Sposobnost ispunjavanja zadataka i poslova pod vremenskim pritiskom i profesionalnom raznolikošću;
- Računarske veštine programskih aplikacija (Word, Excel, Power Point, Access, Internet).

**<u>Procedura Konkurisanja:</u>**
Formular konkurisanja kandidati mogu uzeti na recepciji Nacionalne Kancelarije Revizije ili ga mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a u adresu www.zka-rks.org i dostavljaju se na Odeljenju za ljudske Resurse na adresu: Naselje: Arbëria, ul. "Ahmet Krasniqi" br. 210 – Priština, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00, Formular konkurisanja i prateća dokumentacija mogu se dostaviti i e-poštom na rekrutimi@oagks.org ili poštom. Za detaljnije informacije možete se obratiti na tel. 038 / 606-004, ext: 1005.

**Kandidati trebaju dostaviti potrebna dokumenta:**
- Službeni Formular NKR-a za konkurisanje;
- Kopiju lične karte Republike Kosova;
- Kopije diploma o školskim kvalifikacijama. Diplome stečene van Kosova moraju biti nostrifikovane;
- Kopije drugih profesionalnih kvalifikacija koje se povezuju sa radnom pozicijom;
- Dokaz o radnom iskustvu izdat od strane relevantne organizacije - poslodavca;
- Dokaz da nije pravosnažno osuđen za počinjanje bilo kog namernog krivičnog dela.

Uzimaće se u obzir samo zvanični formular konkurisanja. Formulari konkurisanja dostavljeni nakon isteka roka neće se razmatrati, a nepotpuni obrasci će biti odbijeni.

Kandidati izabrani na užem spisku biće informisani. Takođe i kandidati koji ne ispunjavaju uslove biće obavešteni da nisu izabrani da se podvrgnu proceduru zapošljavanja.
Konkurs je otvoren 15 dana, od dana objavljivanja na štampanim medijama i veb stranici Nacionalne Kancelarije Revizije, počevsi od 26.01.2021, dok je krajnji rok za predaju dokumentacije 10.02.2021, do 16.00. časova.

**Beleška:**
Formulari konkurisanja i dokumenti poslati poštom, koji nose poštanski žig na pošiljci izvršenoj poslednjeg dana roka za konkurisanje, smatraće se važećim i smatraće se ako stignu u roku od tri (3) dana. Formulari primljeni nakon ovog roka i oni nepotpuni sa relevantnom dokumentacijom neće se razmatrati.

Shoqata Humanitare Bamirëse e Kosovës "Nëna Tereze"
The Kosova Humanitarian and Charitable Society "Mother Tereza"
Humanitarno Dobrotvorno Udruzenje Kosova "Majka Tereza"
38400 Prishtinë Rr. Agim Ramadani pn. Tel:00381 38 542 864, Fax: 542 869,
Web site: www.nenatereze.org e_mail:ntereze@yahoo.com

# CONTRACT NOTICE
## *SERVICES*

*According to Article 40 of Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092*

**Date of the preparation of the Notice: 25/01/*2021***

| Procurement No | Enterpreneurship and Mentoring | 002 | 2021 | 221 |
|---|---|---|---|---|

This notice has been prepared in the LANGUAGES:

**English x**

**SECTION I: CONTRACTING AUTHORITY**

**I.1) NAME AND ADDRESS OF THE CONTRACTING AUTHORITY (CA)**

| | | |
|---|---|---|
| **Official name**: Kosovo Humanitarian Charitable Society " Mother Teresa" | | |
| **Postal address**: str. Mujë Krasniqi n.n. Ulpiana U1/1 | | |
| Town: *Prishtina* | Postal code: 10000 | Country: Kosovo |
| **Contact point(s)**: Zef Shala | Telephone: 038-542-865 | |
| Email: zefshala@hotmail.com | Fax: 038-542-869 | |
| Internet address (*if applicable)*: | www.matherteresasociety | |

**SECTION II: OBJECT OF THE CONTRACT**

**II.1) DESCRIPTION**

**II.1.1) Contract title attributed by the contracting authority:**

**Training on Entrepreneurship and Self Employment and Mentoring and Coaching for 240 new beneficiaries** ( **Returnees and people at risk of illegal emigration)**

**II.1.2) Type of contract and location of works, place of delivery or of performance**
*(Choose one category only - works, supplies or services - which corresponds to the main part of the specific object of your contract)*

| | | |
|---|---|---|
| | | x **Services** |

**II.1.5) Short description of the object of the contract**
**Training on Entrepreneurship and Self Employment and Mentoring and Coaching for 240 new beneficiaries** ( **Returnees and people at risk of illegal emigration)**

**II.1.6) Common Procurement Vocabulary classification (CPV)**
**93.000.000.-8**

**II.1.7) Variants are accepted** **No** x

**II.1.8) Division into lots** YES x

**Llot 1 Training on Entrepreneurship and Self Employment for 240 new beneficiaries**
**Llot 2 Individual consultancy Mentoring and Coaching for 240 new beneficiaries**
**II.1.11) Estimated contract value:** ***122,000.00***

**II.2) QUANTITY OR SCOPE OF THE CONTRACT**

**II.3) DURATION OF THE CONTRACT OR TIME LIMITS FOR COMPLETION**

Duration in months 7 month (from the contract signature)
*or*
Starting **15/03/2021**
Completion **15/10/2021**

**SECTION III: LEGAL, ECONOMIC, FINANCIAL AND TECHNICAL INFORMATION**

**III.1) CONDITIONS RELATING TO THE CONTRACT**

**III.1.1) Performance security required** **Yes** ☐ **Yes** ☒

**III.1.2) Legal form to be taken by grouping of economic operators to whom the contract is to be awarded** *(if applicable)*

**III.1.3) Other particular conditions to which performance of the contract is subject** **No** ☒

**III.2) CONDITIONS FOR PARTICIPATION**

**III.2.1) Eligibility Requirements:**
1. Certificate of Business Registration
2. Fiscal Number Registration
3. VAT-Certifikat if applicable

*Documentary evidence required*
**Copy of documentary**

**III.2.2) Professional Suitability:**
1.Business Registration Certificate
2.List of proposed experts and administrative staff and their cv-s
3 References of previous experience in similar projects
*Documentary evidence required:*
**Copy of prove documents**

**III.2.3) Economic and financial capacity**
1. Tax Verification from Tax Administration of Kosovo
2. Company profile

*Documentary evidence required:*
**Copy of documentary**

**III.2.4) Technical and professional capacity**
1.Business Registration Certificate
2.List of proposed experts and administrative staff and their cv-s
3 References of previous experience in similar projects
*Documentary evidence required:*
**Copy of prove documents**

**III.3) CONDITIONS SPECIFIC TO SERVICE CONTRACTS**

**III.3.1) Execution of services is reserved to a particular profession** **No** ☒

**III.3.2) Legal persons should indicate the names and professional qualifications of the staff responsible for the execution of the service** **Yes** ☒

**SECTION IV: PROCEDURE**

**IV.1) TYPE OF PROCEDURE**

**IV.1.1) Type of Procedure**
**x Open**

**IV.2) AWARD CRITERIA**

**Best Economic –favours price**

| Summary of Technical Proposal Evaluation Forms | | Score Weight | Points Obtainable |
|---|---|---|---|
| 1. | Price | 30% | 30 |
| 2. | Relevant experience in similar projects in last 3 years related to ToR and work plan | 40% | 40 |
| 3. | List of proposed experts and administrative staff and their cv-s | 30% | 30 |
| | **Total** | | **100** |

**IV.3) ADMINISTRATIVE INFORMATION**

**IV.3.1) Previous publications concerning the same contract** **No** ☒

**IV.3.2) Conditions for obtaining *tender dossier***
Time limit for receipt of requests for *tender dossier*: **date 05/02/2021**

**Payable documents** **No** ☒

**IV.3.3) Time limit for receipt of *tenders***
***date 25/02/2021 time14:00 place Prishtina***

**IV.3.4) Time limits is shortened for submission of *tenders*** ☒ no

**IV.3.5)** Is tender security needed: **No** ☒

**IV.3.6) Tender validity period:** date: **25/02/2021 days 30 or months 1**

**IV.3.7) Tender opening meeting:**
***Date 25/02/2021 time 14:30 place Prishtina***

**SECTION V: COMPLEMENTARY INFORMATION**

**V.1) COMPLAINTS**

**Any interested party may file a complaint with the Contracting Authority according to article 108/A of the Law No. No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092, at the address specified in Section I of this Contract notice.**

**V.2) ADDITIONAL INFORMATION**

**Note: Economic operators will be entitled to submit a tender, request to participate and other documents required or permitted to be filed during the conduct of a procurement activity in Albanian, Serbian or English.**




RESTAURANT
SWISS
TAVERNA
Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
PRISHTINË

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

OPSTINA STRPCE
KOMUNA SHTËRPCË
MUNICIPALITY OF STRPCE

Komuna Shtërpcë
Drejtoria Komunale për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport

Bazuar në Ligjin e Punës nr.03/L-212 neni 8; Ligjin për Arsim Parauniversitar në Republikën e Kososvës nr. 04/L-032, neni 35 paragrafi 1, 4 dhe 5; Ligji nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, neni 5 pika c; Udhëzimi Administrativ (MPMS) 07/2017; Udhëzimin Administrativ 10/2018 (MASHT) Normativ për Kuadrin e Arsimit të Përgjithshëm, Drejtoria Komunale për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport shpall:

**K O N K U R S**

SHFMU. "Razim Cokli" Brod

Titulli i vendit të punës: Mësimdhënës lëndor/ Teknologji informative, 8 orë mësimore.

Koeficient: A-421/1
Numri i referncës: 08-111/01-824/21
Përshkrimi i vendit të punës:

## DETYRAT KRYESORE

Të zbatoj detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies. Të përgatis me rregull planin mësimor vjetor, mujor dhe ditor në përputhje me Kurrikulën e në pajtim me kërkesat për përshtatjen e mësimdhënies aftësive dhe prirjeve individuale të çdo nxënësi.

Të ketë njohuri për një repertuor të gjërë të stileve mësimore dhe të jetë në gjendje t`i aplikoj ato që më së miri i përgjigjen situatës në klasë.Të shfrytëzoj në mënyrë efektive resurset që i ka në dispozicion. Të planifikoj, të udhëheqë dhe të vëzhgojë nxënien dhe sjelljen e secilit nxënës.

Të zbatoj metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet kurrikulare. Të krijoj një atmosferë pune dhe discipline, pa përdorur metoda ndëshkimi ose forma të ndryshme të poshtërimit ndaj xënësve. Të kontrolloj me rregull dhe të mbaj evidencë për suksesin dhe progresin individual të secilit nxënës si dhe të jetë në gjendje t`i raportoj prindit apo kujdestarit të fëmijës drejt për progresin e arritu të nxënësit sipas kërkesës. Të zgjoj te nxënësit kurreshtjen për të nxënë dhe t`i inkurajoj ata të nxënë në mënyrë të pavarur.
Të kujdeset për zhvilim të vazhdueshëm profesional individual sipas planit të paraparë dhe të kujdeset për realizimin e planifikimit. Të jetë në komunikim të vazhdueshëm me familjen e çdo nxënësi duke realizuar takime individuale me prindër/ kujdestarë të fëmijës.
T`i ndihmojë kolegët për ngritjen e cilësisë së punës.
Të mbikçyrë dhe të udhëzoj nxënësit në procesin mësimor.
Të marrë pjesë në punën e organeve të shkollës.
Të marrë pjesë aktive në përgatitjen e programeve dhe evenimenteve në shkollë, kur kërkohet nga drejtori i shkollës.
Të marrë pjesë aktive në organizimet jashtëmësimore me nxënës dhe kryej me përgjegjësi ekskursionet me nxënës brenda dhe jashtë vendit, sipas udhëzimeve të drejtorit të shkollës.
Të tregoj respekt, sjellje kolegiale dhe jodiskriminuese ndaj bashkëpunëtorëve me të cilët punon.
Të mbajë orën e kujdestarisë dhe kujdestarinë ditore.
I punësuari është i obliguar të respektoj kodin e veshjes dhe të sjelljes, të përcaktuar në rregullorën e brendshme të shkollës.

Kushtet e konkursit:

Për vendin e punës kërkohet kualifikim përkatës profesional, sipas UA. 10/2018 (MASHT):

- Diploma
- Certifikata e lindjes
- Letërnjoftimi
- Vërtetim nga gjykata

Kohëzgjatja e kontratës fillon prej datës së fillimit të punës deri më 31.08.2021

Fletëaplikacionet mirren në DKA ose në shkollë dhe dorëzohen (me dëshmi të verifikuara të kualifikimeve) në objektin e Komunës së Shtërpcës, zyra nr. 28

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e pakompletuara refuzohen.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit zyrtar (tabela e shpalljeve, webfaqen e komunës, gazetë ditore), duke filluar nga data 26.01.2021 deri më 10.02.2021

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria – Vlada - Government*

***Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit***
***Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine***
***Ministry of Economy and Environment***

**Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë**

**për Kushtet Ndërtimore**

**"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".**

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin **"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".**

Nr. prot: 4265/20 të datës 24.09.2020, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

**Posta rekomande:**
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë
Ndërtesa e Rilindjes
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:
http://mmph-rks.org/
Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:
Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor
Suzana.goranci@rks-gov.net
Telefon: + 381 38 200 32 553

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Njomza Osman Kuçi shpall të pavlefshme diplomën e bachelor të lëshuar nga kolegji "Fama".

▶ Viktoria Asllan Bytyçi shpall të pavlefshme diplomën bachelor të lëshuar nga kolegji "Fama".

▶ Festim Qelavet shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

▶ Agim Rama shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

▶ Velija Rejhan shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI - IX shf "Shari" Jabllanicë.

▶ Vilman Qovanaj shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren .

Ahmet Ponik shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Fadil Hisari" Prizren.

▶ D.P.Z. "Trevira-D" Daut Bajgora shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 600882014.

▶ Fatmir Shahini, B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së me nr. 330091968 Gjilan.

▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
RC cola
0.5L